

## Koxijas

"Erga omnes"  
që dallon nga  
Maqedonia  
e Greqisë

Fq.4



## VAZHDOJNË NDARJET

BESA e Kasamit  
shqyrton hyrjen  
në Qeveri

Fq.5



Nuk më  
mbron ajo  
që kam  
bërë  
si lojtar

Fq.22



# Koha

www.koha.mk

E vetëvrara  
e Mlladiçit!

Fq.16

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3263 · e mërkurë 10 janar, 2018

0°C | +6°C

15 DEN

### AKTUALE

Më shumë  
kompjuterë  
në podrum  
se në klasë



Në Maqedoni nuk janë të pakta shkollat që për mungesë të hapësirave, nuk mund të vendosin në përdorim mjetet e teknologjisë informatike. Kështu për shembull, në objektin e ish-Kombinatit Industrial dhe Bujqësor në Kumanovë ku prej shumë vitesh janë sistemuar...

Fq.7

### RAJON

Vetëvendosje  
po ec nëpër  
akull

Fq.14

### SPECIALE

Kush janë  
protestuesit  
e Iranit?

Fq.18

### GLOBI

Peticion  
për shërimin  
e Kasimit  
të vogël

Fq.15



MUNGUAN NËNTË DEPUTETË TË LSDM-SË PËR TË VOTUAR LIGJIN

# LSDM TAKTIZON ME LIGJIN PËR SHQIPEN



Ishin nëntë deputetë të LSDM-së që munguan në seancë - mes tyre edhe koordinatori i grupit parlamentar, Tomisllav Tuntev. Ndërkaq deputetët shqiptarë, përveç kryetarit të PDSH-së, Menduh Thaçi, të gjithë ishin prezent duke qenë të gatshëm të votojnë Ligjin për shqipen. Madje, edhe vet kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti, priste në vendin e tij

Fq.3

## Edhe një premtim për urën e papërfunduar

Tetovë, 9 janar - Ura e re e ndërtuar e Kazazëve ishte inauguruar gjatë fushatës parazgjedhore për zgjedhjet lokale të vitit 2017 në Maqedoni. E njëjta u përrua në një ceremoni të organizuar nga Shtabi zgjedhor i kryetares aktuale të Komunës së Tetovës, Teuta Arifi e cila premtoi përfundimin e shpejtë të saj. Por premtimi ishin dhënë edhe më herët - që në vitin 2016, kur kishin filluar punimet. Ndonëse premti-

met kanë qenë se për dy muaj punimet do të përfundojnë, megjithatë ende nuk ura nuk është funksionale. Sot e kësaj dite, ose gati dy vjet më pas, kjo urë kalohet me vështirësi nga këmbësorët, ndërsa për automjetet ende është e pakalueshme, sepse punët kanë ngelur përgjysmë. Nga Komuna e Tetovës vonesat gati se dyvjeçare i kanë arsyetuar me kushtet klimatike, duke dhënë edhe një...

Fq.9



## NË FOKUS

## GREKOMANIA



Mihal GRAMENO

Dija është sot vegla më e shëndoshe e njerëzimit edhe e qytetërimit, se me dijen kanë harirë të ndryshojnë jo vetëm faqen e dheut po edhe natyrën, se gjithë ç'na shohin sytë e na deëgjojnë veshët, janë të çpikurat e mendjes së njeriut. Gjithë me dijen harinë të xbutin kafshët e shpësët gjer në një shkallë, sa sot i sjellin njerëzimit ato më të mbëdhatë shërbime. Me dijen harinë gjithë kombet e dheut të qytetërohen, të përparojnë edhe të rojnë të lumturë në këtë botë. Prapë me dijen harinë të shpëtojnë njerëzimin nga reziku i vdekjes, duke gjetur mikrobet e tmeruar të oftikës, kolerës, murtajes edhe gjithë sëmundjeve! Pra, kur çuditemi me këto të çpikura të dijes, nuku munt të mos qëndrojmë e të habitemi që qysh kjo ditë nuku mundi të gjenjë edhe mikrobet të grekomanisë?! Edhe megjithëqë kjo sëmundje është re në Shqipëri, po, duke mos marrë masa kundra saj, kishte zënë të përparojë e gadalë të rënjoset, edhe zot'i math e di sa thesare do të kishte, po të mos zgjohe-shin e të kupëtonin reziknë e t'i gjenin një derman shqipëtarët këti mikrobi të tmeruarë. Grekomanija, është një sëmundje e rezikçime që shëmbëllen me gangrenën, të cilën, po s'more masa të repta që në krye, je i dënuar për vdekje! Grekomanija është përhapur në krye, si shpëtimi tonë, grekomanija është përhapur, në krye, si copëtimi tonë edhe kësioj nuku vërenin reziknë po përkundra e pushtinin, kur, tani 30 vjet, u çfaq faqezaj këjo sëmundje në Shqipëri. Mikrobet të grekomanisë këtu në Korçë, ku kanë qëndrën, i prunë, jo korçarët po ca fanatikë pa ndjenja njeriu ose të shitur, nga Athina e Greqisë edhe kështu hodhë grindjen e zihjen midis vëllazërisë që kanë patur gjithë jetën korçarët. Shumë keq më vjen të përdor fjalë si «trathëtar» e «i shitur» edhe aqë më shumë për vëllazër shqipëtarë, po faji është i atyre, të cilët janë bërë vegla e të huajve edhe armikët e kombit të tyre. Qysh munt ta nemëronj e quanj klikën ose kamarillën e Mitropolisë me Efremin nga Elbasanin edhe Jani Dardhën me &-inë? Nuk se s'janë korçarë pa flas për këta, po këta janë shkakatë e gjithave ç'kanë ngjarë e ngjasën në Korçë. Qysh mundet njerës të mbaruarë në shkollat e larta të jenë kundra kombit tyre, përveç se janë të shitur? Një komp pret shërbime nga të kë-tillë njerës e jo intriga e armiqësi. Në thëncin se me këtë mënyrë duan t'i sjellin dobi kombit, këjo i lakuriqëson edhe më tepër që s'janë tjetër gjë përveç propagandistë të grekomanisë, se tjetër soj qysh munt të mbushin qëllimnë, kur kërkohet të ndajnë orthodhoksët nga muhamedanët e nga katolikët? Po propaganda e tyre duket faqezaj që është pas programit të megali idhesë, që të na grekosin e të humbasim gjuhën e bukur tonë, si e panë që më s'mbeti lugë për grekërit në Bullgari, Rumania dhe Serbi. Mos muhamedanët u trazuan në punërat e kishës e të shkollave të orthodhoksëve? Përse atëherë, kur kishin e kanë qëllim të mirë, e ndaluanë lëçitjen e ungjillit edhe të tjerave që thuheshin shqip? E mallëkonin me katran gjith' ata që kuxonin të thonë që janë shqipëtarë? Ç'ishin gjith' ato amendaz (geza) që u epnin fëmijës për çdo fjalë që thoshnin shqip? Zoti Efremin muntë më mirë të ndalonte Elbasanasit, të cilët lëçitnin edhe sot në kishrat shqip, a s'janë dhe ata orthodhoksë? Falje zotit, i cili s'na la të gjurmojmë këtë udhë të shtrembër e të njohim njëri-tjetrin. Mjerisht, gjenden akoma nga vëllazërit korçarë që gjyrmojnë këtë kamarillë, edhe kjo është një turp i math! Është koha që të hapin sytë e të gjykojnë të drejtën për të mirën e mëmëdheut e të vëllazërisë, andaj bën një thirrje duke lutur të hiqni dorë nga grekomanija e tjetër sëmundje si kjo, që të mos lini emër të shkruar me katran. Sa për trathëtoret istorija do t'u ruajnë çpërblimnë që meritojnë!...

("KORÇA", Korçë, nr. 11, 8 maj 1909)

## ZËRI I VIKTIMAVE NUK MUND TË MBYTET

"Diktatura ushtarake në Argjentinë mori fund para 34 viteve. Viktimat kërkuan 34 vjet drejtësi. Në fund të nëntorit 48 ish-ushtarakë u dënuan me burg për keqtrajtimin dhe vrasjen e 789 njerëzve. Nëse ndokush në Kosovë mendon se familjet e viktimave duhet të heshtin - e ka shumë gabim. Refuzimi për të folur për anët e errëta të historisë më të re të Kosovës na bën shoqëri johumane, të padrejtë dhe antiperëndimore. Këtë, me sa duket, nuk duan ta kuptojnë shumë aktivistë të shoqërisë civile dhe propagandues të ndryshëm cinikë, andaj sillen me aq oportunitizëm dhe shpërfillje ndaj viktimave", shkruan publicisti Enver Robelli.



## PASQYRA E KULTURËS SIPAS HARXHIMEVE

"Gjatë Lojërave Olimpikë të vitit 2012 që u mbajtën në Londër, pos ngjarjeve sportive, qenë shënuar edhe momente dhe ndodhi tjera interesante. Një nga ngjarjet me të cilën u morën shumë mediat ishte harxhimi i delegacioneve zyrtare apo shtetërore që kishin ardhur për të përcjellur lojërat olimpikë. Klasifikimi i harxhimeve të delegacioneve që ndarë në tri kategori, sipas të cilava, kriter ishte çmimi i hotelit: 1. Në hotelet super të shtrenjta ose superluksoze, në të cilat një natë kushtonte disa mijëra funta, qenë vendosur delegacionet e shteteve më të varfra, zakonisht afrikane, të cilat udhëhiqen nge regjimet diktatoriale dhe të korruptuara; 2. Në hotelet mesatare qenë vendosur kryesisht delegacionet e shteteve të fuqishme ekonomike, zakonisht evropiane; 3. Kishte edhe kategori të tretë të hoteleve, më të lira se mesataret dhe në to qenë vendosur delegacionet e shteteve skandinave dhe të disa vendeve tjera demokratike. Kategoria e parë, pra diktatorët dhe të korruptuarit, të cilët në Afrikë janë lloj halabakësh, bënë shpenzime astronomike edhe jashtë hotelit. Ata lojërat olimpikë i konsideronin pushim. Prandaj, me vete i kishin marrë gratë, vëllazërit, kunatat, dajtë, shokët dhe ndonjë akraza tjetër. Dhe, gjëja më e rëndësishme për ekonominë e Londrës, ishte se kjo kategori, nëpër dyqanet e kryeqytetit britanik, blinte gjëra pa hesap. Këta ishin njerëz që kishin nevojë të tregonin se në Londër mund të flinin në hotelet më superluksoze, të hanin ushqimet më ekzotike dhe të blinin gardërobën më të shtrenjtë. Pse këta kanë një nevojë të këtitillë, është çështje që dihet. Kategoria e dytë dhe e tretë nuk dilte në 'shopping' sikur e para. Këta nuk tregonin se kishin ndonjë nevojë apo dëshirë të papërbushur. Pra, këta nuk harxhonin asgjë jashtë elementares. Këtu do të na ndihmonte për shpjegim edhe rasti i harxhimeve në hotelin e shtrenjtë të Zvicrës që bëri kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj. Kosova, pa asnjë dyshim, bënë pjesë në kategorinë e parë", shkruan në FB, publicisti Daut Dauti.

## SHTYPJA E PUNËTORËVE

"Rreth 35 për qind është niveli i papunësisë në Kosovë ndërsa kah të sillësh lexon në dyert e lokaleve apo bizneseve të vogla, të mesme dhe të mëdha 'kërkojmë punëtorë'. Shtypja e punëtorëve me orar të gjatë dhe paga ekstrem të ulta i detyron të ikin jashtë, por ka edhe që printojnë të punojnë. Këtu diçka nuk po më lidhet!", shkruan në profilin e tij në Facebook, gazetari Mefail Bajqinovci.



## MEDIACitate

Një udhëtim i anuluar i kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj në Iowa të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për shkak të mos lëshimit të vizës, ka nxitur debate në Kosovë, nëse lidërshtipi i këtuashëm mund të përballë me masa izolimi pas disa përplasjeve me përfaqësuesit ndërkombëtar. Mospërfillja e vazhdueshme e thirrjeve nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian për ratifikimin e Marrëveshjes së demarkacionit të kufirit me Malin e Zi dhe nisura në Kuvendin e Kosovës për shfuqizimin e Ligjit për Gjykatën Speciale, nga analistë vendorë ishin vlerësuar se mund të përcillen me pasoja për Kosovën dhe liderët e saj.

(REL, 9 janar)

Kryetari aktual i Prishtinës, Shpend Ahmeti gjatë një takimi me kryeministrin e Kosovës Ramush Haradinaj, është pyetur edhe për zhvillimet e fundit në Lëvizjen Vetëvendosje. Ai me këtë rast tha se ajo që po ndodh në Lëvizjen Vetëvendosje nuk është normale, por që do të na mbajnë të informuar lidhur me zhvillimet aty. "Kjo që po ndodh në Vetëvendosje nuk është bash normale, por besoj që do ju mbajmë të informuar mbi gjanat që ndodhin në Lëvizje", ka thënë shkurtimisht ai.

(Zëri, 9 janar)

Qeveria e Kosovës është duke punuar për të përgatitur aplikimin për anëtarësim në Këshillin e Evropës, i cili sipas zyrtarëve institucional, Kosovës do t'i hapte perspektivë të madhe në rrugën drejtë anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Zëvendëskryeministri dhe ish-ministri i Jashtëm i Kosovës, Enver Hoxhaj në një intervistë të dhënë për lajmi.net ka thënë se Kosova në vitet e fundit ka bërë përgatitjet preliminare për të aplikuar për anëtarësim në Këshillin e Evropës. Ai po ashtu ka treguar edhe për dobitë që do të ketë Kosova pas anëtarësimit në Këshillin e Evropës duke shtuar se anëtarësimi në këtë organizatë ndërlidhet me zbatimin e suksesshëm të Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim me Bashkimin Evropian si dhe procesin e aplikimit për statusin e kandidatit për anëtarësim në BE.

(lajmi.net, 9 janar)

NËSE NUK  
E KENI DITUR...

## ÇFARË ISHTE MBLEDHJA E BUKURESHTIT?

Mbledhja e Bukureshtit (5 nëntor 1912) ishte mbledhje e përfaqësuesve të kolonisë shqiptare të Bukureshtit e kryesuar nga Ismail Qemali dhe Luigj Gurakuqi. Shpërthimi i Luftës I Ballkanike dhe fitoret e shpejta të aleatëve ballkanikë kishin krijuar një situatë shumë të ndërlikuar dhe kritike për shqipëtarët. Në këto kushte u mbajt mbledhja e

Bukureshtit ku u vendos të formohej sa më parë në Shqipëri një komitet drejtues që të merrte në dorë qeverisjen e vendit, të krijohet një komision që do të shkonte në Evropë për të mbrojtur projektin përpara Fuqive të Mëdha dhe një komitet në Bukuresht që do të bashkërendonte veprimet brenda e jashtë Shqipërisë.



NË SALLË MUNGUAN NËNTË DEPUTETË TË LSDM PËR TË VOTUAR LIGJIN

# LSDM TAKTIZON ME LIGJIN PËR SHQIPEN



Ishin nëntë deputetë të LSDM-së që munguan në seancë - mes tyre edhe koordinatori i grupit parlamentar, Tomisllav Tuntev. Ndërkaq deputetët shqiptarë, përveç kryetarit të PDSH-së, Menduh Thaçi, të gjithë ishin prezent duke qenë të gatshëm të votojnë Ligjin për shqipen. Madje, edhe vet kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti, priste në vendin e tij

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 9 janar - Të martën në seancën e 27-të të Parlamentit të Maqedonisë për mungesë kuorumi është shtyrë votimi i Ligjit për përdorimin e gjuhëve edhe atë për ditën e enjte në ora 12, ashtu siç theksoi kryeparlamentari Talat Xhaferi. Ishin nëntë deputetë të

LSDM-së që munguan në seancë, mes tyre edhe koordinatori i grupit parlamentar të LSDM-së, Tomisllav Tuntev. Ndërkaq deputetët shqiptarë, përveç kryetarit të PDSH-së, Menduh Thaçi, ishin të gjithë prezent duke qenë të gatshëm të votojnë Ligjin për shqipen. Nga BDI, përveç tetë deputetëve dhe kryeparlamentarit Xhaferi, nuk mungoi as kryetari i saj, Ali Ahmeti. Në ndërkohë, përveç dy deputetëve të ASH-së - kryetarit të saj Ziadin Sela dhe Syrija Rashidi, se do të votojë "pro" Ligjit u deklaruan edhe të pesë deputetët e Lëvizjes BESA: Nexhmedin Kahremani, Rexhep Memedi, Afrim Gashi, Fadil Zendeli dhe Teuta Bilalli. Votë "pro" Ligjit pritej edhe nga deputetja e PDSH-së, Merale Yzeiri Ferati. Nga deputetët e pavarur prezent ishte Çedomir Sazdovski, ndërsa në sallë nuk u pa deputeti rom - Amdi Bajram. Nga

LSDM thanë se nuk bëhet fjalë për asnjë taktikë, por se deputetët munguan për arsye personale. Nga BDI lidhur me mosprezencën e deputetëve të LSDM-së thanë se "nuk besojmë se ka ndonjë tendencë apo taktikë për shtyrje të ligjit, po presim të enjten që përfundimisht të votohet Ligji për shqipen". Për votimin e Ligjit për gjuhët duhen së paku 61 vota që të kalojë. Siç dihet, nëse Ligji do të votohet të enjten, gjuha shqipe do të jetë gjuhë e dytë zyrtare përveç gjuhës maqedonase në të gjitha institucionet e pushtetit qendror, ndërsa në institucionet gjyqësore do të jetë zyrtare vetëm nëse njëra nga palët e procesit gjyqësor është shqiptar, gjykatës, prokuror, avokat, pala e dëmtuar, i akuzuari i padituri, procesmbajtësi, përkthyesi, dëshmitari. Përveç kësaj, Ligji për gjuhët parashihet që gjuha shqipe të jetë e shënuar edhe

në bankënotat dhe uniformat policore dhe ushtarake, por për këtë duhet pritur që nëntë që prekin këto fusha - të dërgohen për mendim në Komisionin e Venecias nëse janë në pajtim me Kushtetutën e vendit, por kjo do të ndodh menjëherë pasi të hyjë në fuqi ky Ligj. Kur jemi tek hyrja në fuqi e Ligjit - është e pritshme që presidenti Gjorgje Ivanov të mos e dekretoj Ligjin, që do të thotë se i njëjti do të kthehet pas 30 ditësh në votim dhe nëse kalon sërish - do të hyjë në fuqi menjëherë. Krahas Ligjit për gjuhët, kuorum nuk pati as për votimin e kandidatëve për gjykatës të Gjykatës Kushtetuese - profesorin universitar Osman Kadriu dhe Darko Kostadinovski. Këto dy emra janë propozuar nga ana e presidentit Ivanov pas një konsultimi, siç ka thënë ai, me persona të fushës akademike dhe të jurisprudencës.



BUGAJSKI PËR GAZETËN "POBJEDA"

## Moska e fut në grindje Ballkanin me parimin "përça dhe sundo"

Podgoricë, 9 janar - Moska me propagandë dhe provokime do të vazhdojë që të krijojë tensione midis Malit të Zi dhe Serbisë dhe të gjithë fqinjëve në Ballkan, vlerëson analisti amerikan Janush Bugajski në intervistën për gazetën "Pobjeda" të Podgoricës. Investiguesi i Qendrës për Analizën e Politikave Evropiane paralajmëroi se Moska do të përpiqet që "nga të gjitha kontestet bilaterale në vendet në Evropën Juglindore të bëjë një konflikt latent". Bugajski vlerësoi se strategjia me të cilën sillet Moska kundrejt fqinjëve të saj dhe vendeve të Evropës Juglindore është shembull i politikës klasike mbretërore - "përça dhe sundo". Ai konsideron se vendet nga rajoni duhet që të zbatojnë tre politika, me qëllim që t'i kundërpërgjigjen strategjisë "përça dhe sundo" të presidentit rus Vladimir Putin. "Fillimisht duhet që ta përforcojnë ndërgjegjen e opinionit për sulmet politike dhe informative të Kremlinit. E dyta duhet që të vendosin grupe bilaterale pune me shtetet fqinje, të përbëra nga shkencëtarë dhe ekspertë për propagandë kibernetike që të mbrohen nga sulmet. E treta, të gjitha përvojat me propagandën e Kremlinit duhet që të ndahen që të zhvillohen iniciativat rajonale, veçanërisht ato në sferën informatike", rekomandon Bugajski. Ai vlerëson se kontestet shumëvjeçare bilaterale në rajon nuk do të zhduken brenda një nate, por edhe se çdo shoqëri nuk duhet që të lejojë konteste të tilla që t'i shfrytëzojnë palët e treta. Sipas tij, të gjitha qeveritë në Ballkan duhet të bashkëpunojnë më afër me SHBA-në dhe BE-në përmes strategjive efektive rajonale në kuadër të cilave zbuluesit do të ndajnë informacione, do të punojnë së bashku në fushën e sigurisë kibernetike, luftës kundër korrupsionit dhe kontrollit të faturave bankare. Bugajski beson se integrimi i rajonit në BE dhe në NATO mund të arrijë në 10 vitet e ardhshme.

## Evropa hap dyert për Ballkanin më 2025

Në dokument theksohet se Shqipëria, Bosnja, Maqedonia dhe Kosova "duhet të jenë në nivel të avancuar në rrugën evropiane deri atëherë", ose, sipas një alternative tjetër "negociatat... duhet të avancojnë deri atëherë"

Bruksel, 9 janar - Bashkimi Evropian po përgatitet që të caktojë përfundimisht vitin 2025 si afat të fundit

për valën e re të zgjerimit, por shtetet e Ballkanit mund t'i ndryshojnë gjërat. "Partnerët e Ballkanit Perëndimor tani kanë një mundësi historike. Për herën e parë, perspektiva e pranimit të tyre është në afat kohor më të mirë", thuhet në një letër të siguruar nga "EUobserver" që pritet të shpalojë më 14 shkurt nga Bashkimi Evropian. "Me dëshirën e fortë politike, reformimin real dhe zgjidhjet e qëndrueshme ndaj mosmarrëveshjeve mes fqinjëve, Mali i Zi dhe Serbia duhet të jenë gati për praninë më 2025". Aty theksohet se Shqipëria, Bosnja, Maqedonia dhe Kosova "duhet të jenë në nivel të avancuar në rrugën

evropiane deri atëherë", ose, sipas një alternative tjetër "negociatat... duhet të avancojnë deri atëherë". "Serbia dhe Mali i Zi tashmë kanë hapur negociatat për anëtarësim në BE. Shqipëria dhe Maqedonia po shprehin ta bëjnë këtë sivjet. Maqedonia duhet të rregullojë fillimisht problemet për emrin me Greqinë. Bosnja, pritet të marrë statusin e kandidatit për anëtarësim në BE, ndërsa Kosova konsiderohet që zyrtarisht të emërohet si kandidatë". Në dokument theksohet se problemet mes shteteve në Ballkan mund të bllokojnë planin "ambicioz". Aty propozohet që secila mosmarrëveshje për kufij duhet të zgjidhet përmes instan-

cave më të larta si Arbitrazhi dhe çdo vendim duhet të jetë "i detyrueshëm, përfundimtar" dhe "plotësisht i respektueshëm". Problemi më i madh shihet mosnjohja e pavarësisë së Kosovës nga Serbia. Komisioni thotë se "normalizimi i marrëveshjeve mes Serbisë dhe Kosovës në formë të një marrëveshje ligjore të detyrueshme" do të ishte "krucale" për rrugën e të dy vendeve drejt BE-së. Për Kosovën, problemet janë edhe më të mëdha. Pesë shtete të BE-së nuk e kanë njohur pavarësinë, shkruan "EUobserver". Aty përmendet edhe tentativa për bllokimin e Gjykatës Speciale si dhe refuzimi i vizës amerikane për kryeministrin Ramush Haradinaj.

Koxijas thotë se qëllimi i Athinës është të gjendet emër i përbërë, i cili mundet, por edhe nuk është e thënë të jetë me përcaktim gjeografik. Për emrin "Sllavo Maqedonia", tha se nuk është i pranueshëm për shqiptarët në Maqedoni dhe i përmendi disa emra konkretë nga e kaluara

Athinë, 9 janar - Greqia preferon emër të përbërë që do ta dallonte "IRJM" nga Maqedonia e Greqisë i cili do të jetë për përdorim të përgjithshëm, deklaroi ministri i Punëve të Jashtme të Greqisë, Nikos Koxijas, njofton korrespondenti i MIA-s nga Athina. Në një intervistë për TV Antena greke, Koxijas në detaje foli për çështjen e emrit dhe për pozitat greke. Ai sqaroi se partneri i koalicionit në Qeveri, Panos Kamenos është kundër përdorimit të termit Maqedonia, por në gjuhën greke, tha se në Greqi nuk është e nevojshme të shpallet referendum, theksoi se për vendin tonë tashmë ekziston një emër i përbërë, ndërsa ai është Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe porositi se pa zgjidhje dhe marrëveshje nuk mund të ekzistojë anëtarësim në NATO. Duke i komentuar emrat e publikuara në media si zgjidhje të mundshme të kontestit, shefi i diplomacisë thekson se Qeveria në Athinë e ka propozimin e vet i cili do të jepet në bisedimet me autoritetet në Shkup. Koxijas thotë se qëllimi i Athinës është të gjendet emër i përbërë, i cili mundet, por edhe nuk është e thënë të jetë me përcaktim gjeografik. Për emrin "Sllavo Maq-

KOXIJAS TREGON VIJËN E KUQE

# EMËR "ERGA OMNES" QË DALLON NGA MAQEDONIA E GREQISË

donia", tha se nuk është i pranueshëm për shqiptarët në Maqedoni dhe i përmendi disa emra konkretë nga e kaluara. "Gjithashtu ekzistojnë një sërë propozimesh të dorëzuara nga ministri i atëherëshëm i Punëve të Jashtme i Portugalisë, në vitin 1992 ose nga Vens dhe Oven, të cilët propozuan "Maqedonia e Re" ose si një fjalë ose si dy. Këto propozime janë regjistruar dhe janë lëndë për të cilat do ta

bëjmë zgjedhjen tonë dhe si kabinet qeveritar arritëm deri tek opsionet tona në bisedimet që i kemi me personat zyrtar të vendit fqinj. E përsëris, emër të përbërë, një, për të gjitha përdorimet", tha Koxijas. Ai thotë se e shpreh pozitën e qeverisë greke, ndërsa i sqaroi edhe qëndrimet e partnerit të koalicionit, liderit të Greqëve të Pavarur, Panos Kamenos. "Zoti Kamenos tha, se nuk pajtohet me përdorimin e termit "Ma-

qedonia", por pajtohet me përdorimin e termit "Maqedonia" në gjuhën greke. Kjo është shumë e rëndësishme. Dhe duhet të shohim se si do të dalë kjo prej vetë negociatave", sqaroi Nikos Koxijas, transmeton MIA. Lidhur me shpalljen eventuale të referendumit në Greqi, shefi i diplomacisë greke, tha se nuk ka kurrfarë arsye për mbajtjen e tij, pasi që ekziston një qeveri me përgjegjësi, ekziston shumicë në

parlamentin grek dhe marrëveshja do të kalojë siç është paraparë.

Sipas Koxijas, i cili sot në Athinë duhet të ketë takim me zëvendëskryemistrin për Çështje Evropiane, Bujar Osmani, referendumi për emrin nuk është zgjidhje e mirë as për Maqedoninë pasi që ekziston mundësia marrëveshja eventuale të hidhet poshtë, gjë që do të shkaktojë pasoja negative për vendin. Theksoi se edhe në vitin 1995 u dakordua emër i përbërë, pa referendum. Lidhur me anëtarësimin e Maqedonisë në NATO, Nikos Koxijas thotë se "Pushteti i vendit mik", e di se nuk mund të integrohet në organizatat ndërkombëtare, pa u zgjidhur çështja e emrit, me ç'rast gazetari nga Athina, kërkoi përgjigje nëse kjo do të thotë veto e re dhe përsëritje e asaj që ndodhi në Bukuresht. "Shkupi nuk do të integrohet në NATO, nëse nuk arrihet marrëveshje për emrin", u përgjigj shkurt shefi i diplomacisë greke.

## RAUND I RI I BISEDIMEVE PËR EMRIN MË 17 JANAR NË NJU-JORK

**Raundi i ri i bisedimeve për zgjidhjen e kontestit të emrit do të mbahet më 17 janar në Nju-Jork, konfirmojnë nga MPJ-ja për MIA-n. Është parashikuar që ndërmjetësi i KB-së, Methju Nimic të takohet me negociuesit nga Maqedonia dhe nga Greqia, Vasko Naumovski dhe Adamantios Vasilakis. Raundi i fundit i bisedimeve për emrin, pas ngecjes trevjeçare, u mbajt në Bruksel më 11 dhe 12 të muajit të kaluar. Atëherë është paralajmëruar se ndërmjetësi Nimic çdo muaj do të mbajë takime**

**me negociuesit, me qëllim që të gjendet zgjidhje. Raundi i ri i bisedimeve vjen në periudhë të aktiviteteve të intensifikuara dhe optimizmit në Shkup, Athinë, Bruksel dhe Uashington, për mbyllje përfundimtare të kontestit dydekadësh me emrin. Kryeministrat e Maqedonisë dhe të Greqisë, Zoran Zaev dhe Aleksis Cipras, në ditët e kaluara deklaruan se ekzistojnë mundësi që të gjendet zgjidhje për kontestin në gjysmën e parë të vitit 2018.**

OSMANI NIS TAKIMET NË ATHINË

## KEMI MUNDËSI HISTORIKE T'I JAPIM FUND ÇËSHTJES ME EMRIN

"Kemi progres të dukshëm të komunikimit mes dy vendeve, gjë që shpie dukshëm kah rritja e besimit mes dy vendeve, por edhe në përgjithësi, rritja e besimit mes dy shoqërive", thekoi Osmani



si dhe zëvendës ministrin e Punëve të Jashtme i obliguar për çështje evropiane dhe marrëdhënie ndërkombëtare ekonomike, Jorgos Katrugalos. Gjatë takimeve, thuhet në kumtesën e Kabinetit të zëvendëskryeminitrit, u hapën temat e bashkëpunimit të ndërsjellë,

avancimit të komunikimit, si dhe rreth masave të tjera për ngritjen e besimit mes dy vendeve. "Kemi progres të dukshëm të komunikimit mes dy vendeve, gjë që shpie dukshëm kah rritja e besimit mes dy vendeve, por edhe në përgjithësi, rritja e besimit mes dy shoqëri-

ve", thekoi Osmani. Ai shtoi se përmes krijimit të një atmosfere dhe besimit të sinqertë, mund të tejkalohen çështjet e hapura. "Si politikanë, kemi për obligim t'u krijojmë kushte për prosperitet qytetarëve tanë, progres dhe mirëqenie, e për këtë është e nevojshme ta avancojmë bashkëpunimin mes dy vendeve në të gjitha fushat", theksoi Osmani. Ai shtoi se në periudhën në vazhdim, pret përfundim të masave për ndërtim të besimit në të gjitha fushat: ekonomi, kulturë, arsim, ekologji, bashkëpunim ndërkufitar, energjetikë, transport etj., me çka, krahas ndërtimit të mirëbesimit mes shoqërive, qytetarët do të mund t'i ndiejnë përfitimet nga ky bashkëpunim edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë. Në takime, u hap edhe tema e statusit në të cilin gjendet çështja e emrit. "Viti 2018

paraqet mundësi historike për tejkalimin e mosmarrëveshjeve rreth përdorimit të emrit të ve dit tonë, dhe, si politikanë të cilët kemi marr besimin për t'u prirë qytetarëve tanë, kemi për obligim të tregojmë pjekuri dhe seriozitet dhe mos ta lëshojmë këtë shans", tha Osmani. Ai shtoi se në Maqedoni ekziston optimizëm i shprehur qartë për mbylljen e kësaj çështjeje dhe shprehi shpresë, se së bashku me sinjalet pozitive të cilat vijnë nga ana e Greqisë, kjo çështje do të tejkalohet. Krahas marrëdhënieve të ndërsjella, në takime u hapën edhe çështje që kanë të bëjnë me sfidat evropiane, siç janë, mundësia e një krize të re migrantësh, çështja për mënyrën e funksionimit të Unionit dhe pasojat e Bregzimit, zgjerimi i Unionit edhe me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimorë etj.

Athinë, 9 janar - Zëvendëskryeminstri i Qeverisë së Maqedonisë për Çështje Evropiane, Bujar Osmani, në kuadër të vizitës së sotme të punës në Republikën e Greqisë, realizoi takim me ministrin grek të Punëve të Jashtme, Nikos Koxijas,

LËVIZJA ME DY KRYETARË DHE E NDARË NË DYSH

# BESA E KASAMIT SHQYRTON HYRJEN NË QEVERI

Kasami, i cili një ditë më parë mori kontrollin e selisë së partisë në Shkup, tha se ai është kryetari legjitim dhe se situata e krijuar është si rezultat i pakënaqësisë së disa anëtarëve të partisë. Megjithatë, kryetari i "grupit të Shkupit, Nexhmedin Kahramani është ankuar të martën se persona të caktuar e kërcënojnë me jetë



NEXHBEDIN KAHRAMANI

Unë i njoh personat që më janë kërcënuar dhe ato tashmë janë paraqitur në polici. Përmes tyre mund të njihet edhe dora që e hedh gurin dhe e fsheh dorën. Me këtë rast është njoftuar edhe ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski, ndërsa prej tash do ti njoftojmë edhe të gjitha përfaqësitë diplomatike në vend, ambasadën e SHBA-ve, Zyrën e BE-së, të OSBE-së dhe ambasadat e tjera

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 9 janar - Kryetari i njërit grup të Lëvizjes BESA, Bilal Kasami dhe mbështetësit e tij, nuk e përjashtojnë mundësinë e hyrjes në Qeveri. Në konferencën për shtyp të mbajtur të martën, Kasami, i cili konsiderohet i shkarkuar nga "grupi i Shkupit", ndërsa kryetar për "grupin e Tetovës", njoftoi se takimi të martën me kryeministrin Zoran Zaev ka të bëjë me procesin e reformave dhe mbështetjen e ndryshimeve ligjore në këtë drejtim. Mundësinë e përfshirjes në kabinetin qeveritar. Ai nuk mohoi, por nënvizoi se çdoherë ekziston mundësi që një parti të bëhet apo të dalë nga qeverisja. Gjatë sqarimit të zhvillimeve të fundit në Lëvizjen BESA,

Kasami, i cili një ditë më parë mori kontrollin në selinë e partisë në Shkup, tha se ai është kryetari legjitim i kësaj partie politike dhe se situata e krijuar së fundmi është si rezultat i pakënaqësisë së disa anëtarëve të partisë. Por, sipas tij, në asnjë moment nuk bëhet fjalë për ndarje të kësaj lëvizje në dy grupe.

"Selia qendror e Lëvizjes BESA në Shkup, mbrëmjen e 6 janarit është bastisur nga persona të pa autorizuar, rastin të cilin ne e kemi denoncuar në polici. Kështu, me datë 8 janar, unë dhe bashkëpunëtorët e mi kemi ardhur në seli dhe kemi futur brenda, respektivisht gjatë kësaj kohe në zyrat tona kanë qëndruar persona të panjohur. Po ashtu, edhe për këtë rast i kemi njoftuar organet e rendit. Për këto ngjarje shumë medime me ose pa qëllim kanë raportuar se unë dhe bashkëpunëtorët e mi në selinë e partisë kemi futur me forcë. Një konstatim i tillë aspak nuk është i vërtet. Ne e shtrajmë pyetjen, pse duhet ne të fu-

temi në dhunë në zyrat dhe shtëpinë e të gjithë Besatarëve? Sidoqoftë, të gjitha shpifjet, trillimet dhe keqinformimet ju qofshin për nderë të gjithë atyre që e kanë fabrikuar këto lajme, me qëllim mjegullimin e shkeljeve të rënda që i kanë kryer", tha Kasami. Ai, njëkohësisht tha se BESA është një dhe ajo funksionon në bazë të vendimeve që janë marrë në mbledhjen e Këshillit vendor me 6 janar në Tetovë. Nga ana tjetër, ushtruesi i detyrës kryetar i Lëvizjes Besa, Nexhbedin Kahramani (post ky i cili grupi tjetër i Besës ia dha deputetit Kahramani ditë më parë), dy orë para se Kasami të fillojë konferencën për shtyp, ai bëri të ditur se gjatë ditës së hënë ka pranuar kërcënime për jetën e vetë dhe të familjes. "Unë i njoh personat që më janë kërcënuar dhe ato tashmë janë paraqitur në polici. Përmes tyre mund të njihet edhe dora që e hedh gurin dhe e fsheh dorën. Me këtë rast është njoftuar edhe ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spa-

sovski, ndërsa prej tash do ti njoftojmë edhe të gjitha përfaqësitë diplomatike në vend, ambasadën e SHBA-ve, Zyrën e BE-së, të OSBE-së dhe ambasadat e tjera. Megjithatë, unë dua t'ju them të gjithëve se detyrën time të deputetit e kam pranuar për shkak se të gjithë e dinë saktë e qartë se kush i ka marrë votat e Lëvizjes BESA në Tetovë, por kjo tashmë është më pak e rëndësishme se fakti se Lëvizja BESA tashmë është mjaft e konsoliduar, i ka shpallur zgjedhjet e brendshme, muajin tjetër do të mbahet Kongresi dhe gjithçka është në rregull", tha deputeti Kahramani. Ndryshe, ai ka shtuar se përveç dinjitetit intelektual e profesional, ai krahas votuesve deri në mbajtjen e Kongresit, do ta përfaqësojë Lëvizjen BESA në përgjithësi. Akuzat e tilla dhe kërcënimet ndaj jetës së Kahramanit i ka dënuar kryetari tjetër i Lëvizjes Besa, Bilal Kasami, i cili apeloj që organet e rendit të merren me këtë çështje. Për dallim nga konferenca e

mbajtur ditë më parë nga deputeti Nexhbedin Kahramani, të cilin në prapavijë e shoqëronin edhe dy deputetët tjerë të Lëvizjes BESA, Afrim Gashi e Rexhep Memedi, të martën përderisa foli kryetari Kasami, mundeshin të vërehen vetëm deputet Teuta Bilalli dhe Fadil Zendeli. Ndërkohë, pjesë e grupit i cili i jep mbështetje Kasamit, ishin edhe disa këshilltarë komunal në Këshillin e Qytetit të Shkupit dhe atij të Çairit. Njëherësh, të dy palët e Lëvizjes BESA, që ditëve të fundit përmes konferencave për shtyp, adresojnë akuza dhe pakënaqësi të ndryshme, thonë se janë duke u përgatitur për pjesëmarrje në Kongresin e partisë i cili pritet të mbahet me 24 shkurt.

MICKOSKI PËRSËRIT MUNGESËN E AMBIENTIT DEMOKRATIK

## VMRO JASHTË PARLAMENTIT

Shkup, 9 janar - Lideri i VMRO-DPMNE-së, Hristijan Mickoski, të martën përsëriti se deputetët e partisë së tij nuk do të marrin pjesë në punën e Parlamentit, sepse siç tha ai, për momentin atje nuk ka ambient demokratik për punë. Ai potencoi se grupi i deputetëve i VMRO-DPMNE-së është i vetëm, i bashkuar dhe absolutisht konstruktiv dhe merr pjesë bashkërisht në krijimin e qëndrimeve dhe vendimeve. "Grupi i deputetëve të VMRO-DPMNE-së në koordinimin e djeshëm vendosi se nuk do të marrë pjesë në punën e Parlamentit për funksionim normal demokratik në këtë institucion", tha Mickoski, i cili konfirmoi se 12 për qind e deputetëve të tyre ende janë në paraburgim, e ato janë pesë për qind nga gjithsej numri i

### DEPUTETI HASANI BRAKTIS VMRO-në

Edhe një deputet nga koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE-ja në Parlamentin e Maqedonisë do të vepron si deputet i pavarur. Bëhet fjalë për Jusuf Hasanin nga Partia Demokratike e Turqve të Maqedonisë. Hasani me shkrim dje e njoftoi kryetarin e Parlamentit, Talat Xhaferi se do të vepron si deputet i pavarur, e jo si deputet i koalicionit "Për Maqedoni më të mirë", duke i përfaqësuar të drejtat, vullnetin dhe votat e votuesve të tij.



deputetëve që përballet me akuzë të ndërtuar për terrorizëm.

I përsërit konstatimet e Avokatit të Popullit se gjatë arrestimit të deputetëve Kërsto Mukoski, Luben Arnaudov dhe Zhaklina Peshenska, më 29 nëntor të vitit 2017 është shkelur e drejta e imunitetit të deputetëve, e garantuar me ne-

nin 64 nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë dhe se efektivët e policisë nuk u janë përmbytur procedurave juridike për arrestim të caktuara me nenin 19 nga Rregullorja për mënyrën e kryerjes së punëve policore, sipas të cilit, nëse gjatë arrestimit të personit i referohet imunitetit në-



punësi i policisë pas që do të kryejë verifikim e ndërpret arrestimin. Sipas Mickoskit, më shumë se e qartë është se kompetentët kanë kryer veprë penale të nenit 140 nga Kodi penal, i cili parashikon sanksione përkatëse për provim antiligjor nga liria. Mickoski tha se ka komunikim me shumicën qeveritare edhe me kryetarin e Parlamentit, por potencoi se ajo bazohet në "në takime jo shumë të shpeshta".

"Kemi komunikim të caktuar kur bëhet fjalë për pjesëmarrje në komisione të caktuara, që janë në

kuadër të Parlamentit. Nuk ka paralajmërim, siç tha, duke u përgjigjur në pyetjen e deputetëve, për takim të ri me kryeministrin Zoran Zaev. Për një pjesë të ligjeve reformatore VMRO-DPMNE, si u përgjigj Mickoski kanë formuar grup të vetin punues, ndërsa grup punues ka edhe shumica qeveritare. Ai tha se nuk janë informuar për takimin që duhet të mbahet më 25 dhe 26 janar në kuadër të procesit Zhan Mone. Punohet në reforma partiake dhe në statusin e partisë, i cili duhet të jetë i gatshëm deri në fund të janarit.

SYTË DREJT GJYQËSORIT

# MES TË KALUARËS DHE REFORMAVE



Reformat e nisura janë pjesë e një raporti të ekspertëve të Bashkimit Evropian, i udhëhequr nga gjermani Rainhard Pride. Nëse reformat e nisura do të jenë të suksesshme dhe efikase, do të dihet në prill kur pritet të publikohet raporti i Komisionit Evropian për përparimin e vendit

Shkup, 9 janar - Pushteti gjyqësor, ndër më të kritikuarit në tre vjetët e fundit, ende është larg pritjeve për pavarësi dhe efikasitet në punën e tij. Tashmë institucionet, si Qeveria ashtu edhe Kuvendi kanë vënë prioritetet e tyre për miratimin e zgjidhjeve ligjore brenda dy muajve të ardhshëm, që janë në përputhje me rekomandimet e Brukselit, si në Prokurori ashtu edhe Këshillin Gjyqësor, por edhe për kërkesat e Prokurorisë Speciale, për të cilën ende nuk ka një zgjidhje se si do të punojë në të ardhmen pas skadimit të afatit për ngritjen e padive ndaj zyrtarëve të inkriminuar. Pas ndërrimit pushtetit në qershor të vitit të kaluar, Prokuroria e rregullt, por instancat tjera si Gjykata Penale, Gjykata e Apelit, si dhe ajo Supreme, ndryshuan formën e veprimit duke miratuar të gjitha masat e kërkuara nga Specialja, por edhe duke ngritur vetë padi të shumta penale, gjë që nuk e bënin deri sa në

fuqi ishte pushteti i kaluar.

"Këshilli Gjyqësor tani vetëm se ka ndërruar kapelën dhe plotëson dëshirat e pushtetit aktual, që është veprim shumë i keq. Pra, ky këshill i cili deri para qershorit punonte për pushtetin e kaluar, tani punon për pushtetin e tanishëm. Ende nuk është ndërruar asnjë anëtar i këtij këshilli, që vlerësoj se është një ndër burimet e së keqes për gjendjen, në të cilën ndodhet Gjyqësori kur dimë se këshilli bën emërimin e gjykatësve në të gjithë vendin", thotë Zvonko Davidoviq, njohës i çështjeve juridike dhe avokat në shumë procese gjyqësore. Ai thotë se ligjet edhe tani që janë në fuqi nuk janë të këqija, por se duhet vetëm zbatimi i tyre. Pavarësisht kësaj, Davidoviq thotë se edhe zgjidhjet e reja ligjore do të jenë të pamjaftueshme nëse reforma nuk do të jetë thelbësore, pra paralelisht të kërkohet edhe përgjegjësi për të gjitha ata punonjës që kanë shkelur apo nuk kanë respektuar ligjin. "Është shumë lehtë të thuhet se do të kemi reforma. Po, por reformat nuk nënkuptojnë vetëm se miratimin e ligjeve. Deklarativisht shohim vullnet, por këtë nuk e shohim në teren. Nëse këtë nuk e ndryshojmë dhe nuk kërkojmë përgjegjësi nga njerëzit që e bëjnë këtë, nuk do të ketë asgjë prej reformave", thekson Davidoviq. Edhe profesori i së Drejtës Kushtetuese, Osman Kadriu, thotë se duhet ende shumë punë për t'i realizuar pritjet për reforma përmbajtësore dhe efektive, në dobi të qytetarëve dhe shtetit që synon



ZVONKO DAVIDOVIQ

**Është shumë lehtë të thuhet se do të kemi reforma. Po, por reformat nuk nënkuptojnë vetëm se miratimin e ligjeve. Deklarativisht shohim vullnet, por këtë nuk e shohim në teren. Nëse këtë nuk e ndryshojmë dhe nuk kërkojmë përgjegjësi nga njerëzit që e bëjnë këtë, nuk do të ketë asgjë prej reformave**

integrimin euroatlantik. "Lëvizje ka, por nuk do të thotë se ato janë realizuar në tërësi. Që kjo të ndodhë, është e nevojshme që të intervenohet në ligjet e sferës së jurisprudencës dhe pastaj të veprohet me hapa konkretë. Në popull ende mbizotëron mendimi se në Gjyqësor ka pasur procese të montuara, në Gjyqësor nuk ka pasur kualitet dhe efikasitet në punë, në Gjyqësor kemi persona që janë të komprometuar dhe të përfshirë në krime të rënda, pa anashkaluar këtu edhe korrupsionin. Këto dukuri patjetër duhet të eliminohen", vlerëson Kadriu. Reformat e nisura janë pjesë e një raporti të ekspertëve të Bashkimit Evropian, i udhëhequr nga gjermani Rainhard Pride. Nëse reformat e nisura do të jenë të suksesshme dhe efikase, do të dihet në prill kur pritet të publikohet raporti i Komisionit Evropian për përparimin e vendit. (REL)

## Aksidentohen dy këmbësorë

Tetovë, 9 janar - Në rrugën "Vëllezërit Miladinovci" në Tetovë të hënën rreth orës 18.30 minuta ka ndodhur një tjetër aksident komunikacioni, në të cilin një veturë e tipit "Ford Eskort" me targa të Tetovës, e drejtuar nga 26-vjeçari me iniciale B.SH nga Negotina e Pollogut ka aksidentuar dy këmbësorë nga Reçica e Vogël të moshës 21 dhe 24-vjeçarë me inicialet B.S dhe H.M. Me lëndimet e marra, dy këmbësorët nga ana e vozitësit janë dërguar në Spitalin klinik të Te-

tovë, ku ju është ofruar ndihma mjekësore dhe më pas janë lëshuar për mjekim shtëpiak. Si shkak për këtë aksident, është mos dhënia e përparësisë së këmbësorëve në vendin e paraparë për kalimin e këmbësorëve. Nga policia informojnë se të martën rreth orës 15.00, në udhëkryqin e rrugëve "Dimo Gavrovski Kara" dhe rrugës "JNA", në Tetovë ka ndodhur një aksident komunikacioni në të cilin janë përfshirë dy vetura edhe atë një veturë e tipit "Tiko" me

targa të Tetovës, e drejtuar nga 36-vjeçari me iniciale N.A nga Brodoci, si dhe një "Wolksfagen Pasat", me targa të Bosnjës të cilën e ka drejtuar 32-vjeçarja me iniciale E.M nga Pallçishti i poshtëm. Vozitësi i Tiko-s si dhe një bashkudhëtarë 11-vjeçar i të njëjtës veturë për pasojë kanë marrë lëndime trupore, dhe me anë të një veture tjetër janë dërguar në spitalin klinik të Tetovës ku pas ndihmës mjekësore të ofruar janë lëshuar për mjekim shtëpiak. (U.H)

## KRONIKË

### Në Çegran kërcënohen burrë e grua

45-vjeçari me iniciale E.S nga Gostivari të hënën mbrëma në orën 2:00 ka denoncuar se është kërcënuar nga një person i panjohur rreth orës 23.30 minuta përderisa me veturën e tij të tipit "BMW", në të cilën ka qenë edhe bashkëshortja e tij. Sipas rrëfimit të tij në polici, ai ka qenë parkuar përgjatë rrugës Tumçevishtë-Çegran, papritmas afër tyre është ndaluar një veturë po ashtu e markës "BMW" dhe nga vetura ka dalur një person i panjohur, i cili e ka kërcënuar me jetën dhe nga dy bashkëshortët ka kërkuar që të dalin nga vetura, ka nxjerrë pistoletën ka gjuajtur një plumb në ajër, dhe më pas me veturën e tij me shpejtësi është larguar në drejtim të Çegranit. Po ndërmerren masa dhe aktivitete për zbardhjen e plotë të rastit të denoncuar, si dhe zbulimin e të përfshirëve në këtë rast njofton policia e Gostivarit.

### Lëndohet këmbësori në Cvetan Dimov

Një këmbësor nga Shkupi është lënduar në aksidentin rrugor që ndodhi të hënën mbrëma rreth orës 21:10 minuta në rrugën "Cvetan Dimov" në Shkup. Siç informoi MPB, automjeti "MBE" me targa të Shkupit, i drejtuar nga A.A. (19) nga Shkupi e ka goditur këmbësorin D.S (30), i cili ka marrë lëndime të rënda nga aksidenti. Ai me ambulancën e Ndihmës së Shpejtë është transportuar në Kompleksin e klinikave "Nënë Tereza", ku nga ana e mjekut i është dhënë ndihmë mjekësore dhe i janë konstatuar lëndime të rënda trupore. Ekspertizë në vendin e ngjarjes ka kryer ekipi i SPB-së Shkup.

### Fundjava me 19 aksidente, dy të lënduar rëndë

Dy persona kanë marrë lëndime të rënda trupore, ndërsa tetë, më lehtë janë lënduar më lehtë në tetë prej gjithsej 19-të aksidenteve të regjistruara në katër ditët e fundit në rajonin e SPB Shkup. Nga Ministria e Punëve të Brendshme informojnë se gjatë fundjavës së vazhduar festive janë sanksionuar 50-të shoferë të cilët kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe nga e lejuara. Janë përjashtuar nga komunikacioni 37-të shoferë të cilët në baza të ndryshme i kanë shkelur ligjet, të cilët kanë vozitur nën ndikimin e alkoolit, kanë drejtuar automjetin para se të fitojnë të drejtën e vozitjes, shoferë fillestarë, si dhe 34, me patentë shoferi të skaduar, me probleme teknike dhe të paregjistruara.

### Vajza e "zhdukur" kishte ikur tek i dashuri

Dje në mesditë në Stacionin Policor në Gostivar në orën 12 është lajmëruar vajza 15-vjeçare, e cila më 7 janar ishte denoncuar se është larguar nga shtëpia, nga babai i saj 50 vjeçar I.P nga Gostivari. Sipas policisë, vajza ishte larguar nga shtëpia mëngjesin e 7 janarit, dhe kishte shkuar tek një djalë me të cilin ishte në lidhje dashurie. Përndryshe, gjatë vitit të kaluar, në rajonin e Gostivarit raste të këtilla ka patur rreth 27 - pjesa dërmuese e gjinisë femërore. Të gjithë këta vajza që janë denoncuar se janë zhdukur nga shtëpia më pas ose janë rikthyer ose janë gjetur tek të dashurit e tyre. Vetëm në dy raste, sipas policisë, dy femra kanë patur problem psikike dhe pa dijeninë e të afërmeve kishin lëshuar shtëpinë, njoftojnë nga Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë. (U.H)

Ndodh që shkollat të ankohen zakonisht për mungesë kompjuterësh dhe pajisjesh të tjera të IT-së, por rasti i paraleleve shqipe të "Nace Bugjonit" flet për një paradoks tjetër, për atë se ekziston mundësia ti posedojnë kompjuterët dhe të mos mund ti përdorin ato. Konkretisht kanë mundësi të përdorin vetëm 265 kompjuterë, ndërkaq 435 kompjuterët e tjerë ruhen në podrum

PËR MUNGESË TË HAPËSIRAVE NË SHKOLLË

# MË SHUMË KOMPJUTERË NË PODRUM SE NË KLASË



sa i përket modernizmit të arsimit. Ndodh që shkollat të ankohen zakonisht për mungesë kompjuterësh dhe pajisjesh të tjera të IT-së, por rasti i paraleleve shqipe të "Nace Bugjonit" flet për një paradoks tjetër, për atë se ekziston mundësia ti posedojnë kompjuterët dhe të mos mund ti përdorin ato. Konkretisht, ata kanë kompjuterë trefish më shumë se sa janë në gjendje të përdorin dhe si rezultat i kësaj - kompjuterët në vend që të qëndrojnë në bankat e nxënësve, mbahen të kyçura në podrum. Arsyeja e vetme është mungesa e hapësirave. Ndihmësdrejtori Saliu tregon se vetëm në një pjesë të lëndëve ka mundësi të punohet me kompjuterë edhe atë vetëm në 12 paralele nga 40 gjithsej. Pavarësimi i paraleleve shqipe nga shkolla "Nace Bugjoni" do të ishte hap i parë drejt kapërcimit të barrierave. Saliu u bën thirrje komitentëve që të mundësojnë pavarësimin e këtyre paraleleve nga shkollat maqedonase dhe të punojnë në themelimin e shkollës së re të teknikës dhe mjekësisë në Kumanovë. Paralelet shqipe edhe ashtu veprojnë të ndara prej shkollave amë prej vitit 2001. Nevojitet thjeshtë vetëm realizmi i një akti politik që është në kompetencë të Ministrisë të Arsimit (MASH) dhe Komunës të Kumanovës.

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 9 janar - Në Maqedoni nuk janë të pakta shkollat që për mungesë të hapësirave, nuk mund të vendosin në përdorim mjetet e teknologjisë informatike. Kështu për shembull, në objektin e ish-Kombinatit Industrial dhe Bujqësor në Kumanovë ku prej shumë vitesh janë sistemuar paralelet e mesme me mësim në gjuhën shqipe, të gjimnazit, teknikës dhe mjekësisë. Pozita e Gjimnazit "Sami Frashëri" duket pak më e mirë krahasuar me paralelet shqipe të Shkollës së Mesme "Nace Bugjoni", të cilat ndajnë të njëjtin kulm. Kjo, pasi gjimnazi është shkollë e pavarur juridikisht, ndërsa paralelet e teknikës dhe mjekësisë janë në varësi të shkollës "Nace Bugjoni", e cila ka në objektin amë vetëm për paralelet me mësim në gjuhën maqedonase. Për këtë arsye, një pjesë e mirë e organizmit të punëve për paralelet me

mësim në gjuhën shqipe, në objektin e ish-KIB bëhet shumë më e vështirë.

Në rastet e pajisjes së paraleleve me teknologjinë informatike, duhet çdoherë që realizmi i gjërave të kalojë përmes drejtorisë së shkollës, e cila gjendet në objektin amë. Por, sa u takon paraleleve shqipe të "Nace Bugjonit", duket se ky nuk është i vetmi problem. Edhe kur është kapërcyer barriera administrative, pra kur kompjuterët që u takojnë nxënësve shqiptarë janë siguruar aq sa u takojnë, del problemi i hapësirave. Ndihmësdrejtori Nexhbedin Saliu, i cili është edhe përgjegjësi për paralelet shqipe, tregon se kompjuterët i posedojnë prej vitesh, mirëpo pjesa më e madhe tyre ruhen në podrum. "Për paralelet në gjuhën shqipe janë si-

guruar të gjitha kompjuterët që na takojnë. Në objektin të cilin e shfrytëzojmë si shkollë, kemi 700 kompjuterë. Mirëpo, për mungesë të kushteve i kemi në përdorim vetëm 265 kompjuterë", deklaroi Saliu. Hapësirat ku janë të vendosura paralelet e teknikës dhe mjekësisë janë të atilla sa nuk na

japin mundësinë e organizmit të mësimin me kompjuterë në më tepër se pesë klasa dhe një kabinet informatike, sqaron ai. Edhe pse një shkollë në rritje sipas numrit të nxënësve, zhvillimi i saj është peng i mungesës së hapësirave dhe pavarësimin në subjekt të veçantë juridik. Kjo, ka edhe ndikimin negativ

## SHQIPTARËT, GATI DYFISH MË SHUMË SESA MAQEDONASIT

Kërkesa për pavarësimin e këtyre paraleleve është dërguar në Komunë dhe MASH që në vitin 2004, mirëpo edhe pas 13 viteve diskutohet po e njëjta çështje. Përgjegjësi i paraleleve shqipe, Saliu thotë se posedojnë të gjithë kuadrin e nevojshëm për funksionimi si shkollë e veçantë. Aktualisht kanë 95 mësimdhënës, pesë punonjës të stafit teknik, një pedagog, një zëvendësdrejtor dhe dy ndihmësdrejtorë. Përveç kësaj, është një shkollë me

perspektivë e cila shënon rritje në numrin e nxënësve. Këtë e vërtetojnë edhe numrat. Nëse në vitin shkollor 2001/2002 shqiptarët kishin tetë paralele, tani kanë 40 paralele me 1170 nxënës. Ndërkaq, në paralelet me mësim në gjuhën maqedonase janë 34 paralele dhe 750 nxënës. Në vitin 2007 u premtua dislokimi i paraleleve shqipe në hapësirat e ish-kazermës ushtarake "Kuzman Josifovski Pitu", por një gjë e tillë nuk u realizua as në vitin shkollor 2017/2018.

RISI NË MANIFESTIMIN TRADICIONAL

## Garë nusesh në Karnavalet ilire të Bozovcës

Nëse edicionet e tjera rolet e femrave realizoheshin nga meshkuj të maskuar si gra, dy herët e fundit janë vetë femrat që bëhen pjesë aktive e grupit të karnavalistëve. Përgatitjet në fshatin Bozovcë kanë nisur dhe organizatorët tregojnë se risia e këtij edicionin do të jetë gara e bukurisë, përkatësisht një pikë ku do të improvizohet një skenë tipike e gazmendeve shqiptare ku nuset e stolisura dhe të veshura me kostumet më të mira vlerësohen për bukurinë, veshjen, grimin, e të tjera

Koha Evis HALILI

Shkup, 9 janar - Është viti i dytë me radhë që Karnavalet Ilire të Bozovcës i kërkojnë risitë përmes përfshirjes gjithnjë e më të madhe të grave në këtë manifestim. Nëse edicionet e tjera rolet e femrave realizoheshin nga meshkuj të maskuar si gra, dy herët e fundit janë vetë femrat që bëhen pjesë aktive e grupit të karnavalistëve. Përgatitjet në fshatin Bozovcë kanë nisur dhe organizatorët tregojnë se risia e këtij edicionin do të jetë gara e bukurisë, përkatësisht një pikë ku do të improvizohet një skenë ti-

prike e gazmendeve shqiptare ku nuset e stolisura dhe të veshura me kostumet më të mira vlerësohen për bukurinë, veshjen, grimin, e të tjera. "Do të jenë nja 7-8 gra të veshura si nuse, traditë kjo që është thellësisht shqiptare, ajo e vlerësimit të bukurisë. Qëllimi është që të tregojmë se ne si popull gjithmonë kemi ditur të vlerësojmë të bukurën, është një lloj si ato garat e bukurisë që bëhen tani, por që në fakt duam të tregojmë se në një formë tjetër kanë ekzistuar edhe dikur", thotë një prej organizatorëve të Karnavaleve të Bozovcës, Neshat Mehmedi. Sipas tij

gjithçka është gati dhe risitë e kësaj natyre, përveç se aktivizimit të grave në këtë manifestim kanë si qëllim që të japin vazhdimisht freski dhe të mos lejojnë përsëritjen monotone të pikave të këtij aktiviteti. Sigurimi i mbështetjes financiare të nevojshme është një prej pengesave me të cilat hasin çdo vit. Karnavalet e Bozovcës mbështeten nga komuna e Tetovës (rreth 2.500 euro), por jo në shumë të mjaftueshme për të krijuar të gjitha kushte komode në mbarëvajtjen e tij. Me këtë projekt është konkurruar edhe në Programin nacional të 2018 në Ministrinë e Kul-

turës, nga ku presin edhe mbështetje financiare për realizimin e tij. Për vetë karakterin e kësaj ngjarje, Karnavalet e Bozovcës që zhvillohen në muajin mars, kanë nga çmuar kureshtjen e studiuesve nga Shqipëria e Kosova. "Kushtet janë të tilla, që nuk mund t'i lejojmë vetes shpenzime më të mëdha, të kemi një prezencë më të madhe të ftuarish, edhe ato që kanë marrë pjesë kanë ardhur me shpenzimet e veta. Kërkojmë mbështetje për të mbajtur ashtu si duhet këtë manifestim për të cilin nga 2009 e këndej më shumë sesa me mbështetje financiare e realizojmë me

entuziazëm. Pasi duhet të ruhet kjo pjesë e traditës, ky karnaval shumë i lashtë, që nga koha e ilirëve", thotë Mehmedi. Karnavalet e Bozovcës janë zhvilluar deri në vitin 1981 dhe u ndërpre për më shumë se dy dekada. Ruajtja e traditave dhe festimi i jetës dhe i begatitë të saj në formën pagane, ashtu si shënohej dikur është një prej synimeve të rifillimit të kësaj tradite. Skenari i kësaj dite është i thjeshtë, mbështetet sa në gojëdhëna të mbledhura nga më të moshuarit, po aq edhe nga materiale të tjera etnografike. Ceremonia nis me nga qendra e fshatit, aty ku tubohen të gjithë për të pleqëruar hallet, organizohen lojëra dhe pika të ndryshme muzikore, por edhe gostiten me ushqimet tradicionale. Në karnavalet e kaluara interpretimi i roleve mashkullore u zëvendësua me tre gra, përkatësisht të veshura si nuse, që prezantojnë jo vetëm traditën e veshjeve kombëtare në ditë të veçanta, por edhe atë të nusërimit.





## VONOHET PËRFUNDIMI I URËS SË KAZAZËVE



Ndonëse premtimet kanë qenë se për dy muaj punimet do të përfundojnë, megjithatë ende nuk ura nuk është funksionale. Sot e kësaj dite, ose gati dy vjet më pas, kjo urë kalohet me vështirësi nga këmbësorët, ndërsa për automjetet ende është e pakalueshme, sepse punët kanë ngelur përgjysmë

# EDHE NJË PREMTIM PËR URËN E PAPËRFUNDUAR

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 9 janar - Ura e re e ndërtuar e Kazazëve ishte inauguruar gjatë fushatës parazgjedhore për zgjedhjet lokale të vitit 2017 në Maqedoni. E njëjta u përrua në një ceremoni të organizuar nga Shtabi zgjedhor i kryetares aktuale të Komunës së Tetovës, Teuta Arifi e cila premtoi përfundimin e shpejtë të saj. Por premtimet ishin dhënë edhe më herët - që në vitin 2016, kur kishin filluar punimet. Ndonëse premtimet kanë qenë se për dy muaj punimet do të përfundojnë, megjithatë ende nuk ura nuk është funksionale. Sot e kë-

saj dite, ose gati dy vjet më pas, kjo urë kalohet me vështirësi nga këmbësorët, ndërsa për automjetet ende është e pakalueshme, sepse punët kanë ngelur përgjysmë. Nga Komuna e Tetovës vonesat gati se dyvjeçare i kanë arsyetuar me kushtet klimatike, duke dhënë edhe një premtim - se në muajin mars do të përfundohet Ura e Kazazëve. "Ura nuk është përfunduar në kohë për shkak të kushteve klimatike që nuk kanë lejuar të realizohen punimet përfundimtare. Me rregullimin e kushteve klimatike në muajin mars në afat prej 15 ditëve do të bëhet përfundimi i punëve që kanë

ngelur, e cila do të mund të përdoret edhe nga automjetet dhe të lehtësojë komunikacionin në këtë pjesë të qytetit të Tetovës", tha Arsim Nuredini, udhëheqës i Sektorit për veprimtari komunale dhe mbrojtje të ambientit jetësor dhe natyrë pranë Komunës së Tetovës.

Përndryshe, Ura e Kazazëve është një nga monumentet e trashëgimisë nga e kaluara. Kjo urë është ndërtuar në shekullin e 16-të dhe e rrënuar në vitin 1979 gjatë vërshimeve në Tetovë. E njëjta është ndërtuar nga Kazazët apo shtresa e Kazazëve, të cilët në kohën e Perandorisë Osmane kanë qenë punëtorë

teknik të ushtrisë osmane, prandaj edhe është thirrur Ura e Kazazëve. E njëjta është rrënuar në vitin 1979 për, siç është thënë, të penguar vërshimin e qytetit nga ujërat e Lumit Shkumbin. Sipas shënimeve, kjo urë përbente një konstruksion inxhinierik interesant të stilit oriental, me një hark me hapësirë drite të mjaftueshme. Ura ka qenë e punuar me gurë të gdhendur nga mjeshtrit vendas. Nga Komuna e Tetovës njoftojnë se me lëshimin në përdorim të kësaj ure, dukshëm do të përmirësohet qarkullimi i automjeteve dhe do të lehtësohet komunikacioni në rrugët përreth, si-

domos në pjesën e Çarshisë së Epërme. Përndryshe, kur filluan punët në muajin tetor, ura e vjetër prej metali është dislokuar, gjegjësisht konstruksioni që shërbente për qarkullim vetëm të këmbësorëve. E njëjta është shfrytëzuar për qarkullim për qytetarët që kanë pasur punë në Sektorin për Punë të Brendshme në Tetovë dhe tek ish objekti i shkollës së mesme të mjekësisë. Krahas kësaj, e njëjta shfrytëzohej nga ana e qytetarëve për punët e tyre në Çarshinë e Epërme. Megjithatë, në bazë të punëve të kryera deri më tani - nuk është ruajtur aspak pjesa e vjetër e urës si monument i trashëgimisë kulturore dhe e njëjta është ndërtuar prej fillimit. Rikujtojmë se kryetarja e Komunës së Tetovës, Teuta Arifi gjatë fushatës theksoi se "bashkë me asfaltimin e rrugës tek stacioni policor në gjatësi prej 370 metrave, trotuareve, ndriçimit dhe kanalizimit atmosferik - është bërë një rehabilitim i dukshëm infrastrukturor i cili do të ndihmojë në qarkullimit të lirshëm të qytetarëve". Pranvera e ardhshme, pati thënë ajo, do ta bëjë këtë rrugë me trotuare, kanalizim atmosferik dhe fekal, ndriçim publik si dhe asfaltim të plotë duke filluar nga Çarshia e Epërme e deri tek rruga e Teleferikut.

## RRITET NUMRI I UDHËTARËVE NGA AEROPORTI I SHKUPIT DHE OHRIT

## STAMBOLLI, TOP DESTINACIONI I QYTETARËVE TË MAQEDONISË

Koha Zejnula VESELI

Shkup, 9 janar - Mbi 2 milionë qytetarë të Maqedonisë kanë udhëtarë nga Aeroporti i Shkupit dhe i Ohrit gjatë vitit 2017 dhe krahasuar me vitin 2016 - numri i udhëtarëve është rritur për 13 për qind. E gjithë kjo, sipas kompanisë "TAV Maqedonia", është si rezultat i vendosjes së linjave të reja në të dy aeroportet. "Viti 2017 për 'TAV Maqedoni' ishte shumë i suksesshëm duke arritur kështu që nga dy aeroportet, ai i Shkupit dhe i Ohrit të fluturojnë mbi 2 milionë udhëtarë. E gjithë kjo u bë e mundur me vendosjen e linjave të reja ajrore në destinacione të ndryshme drejt vendeve të Evropës. Me vendosjen e pesë destinacioneve të reja drejt Budapestit, Maltës, Romës, Vaksjo dhe Doha nga aeroporti i Shkupit dhe linjës ajrore nga aeroporti i Ohrit drejt aeroportit Katowice të Polonisë, krahasuar me numrin e udhëtarëve të viti 2016, kemi rritje prej 13 për qind. Edhe gjatë viti 2018 do të fokusohemi në rritjen e linjave të reja ajrore dhe në ofrimin e kushteve më cilësore për udhëtarët dhe klientët tanë", tha



Ashtu siç është rritur numri i udhëtarëve, Ersoj thotë se është rritur edhe numri i fluturimeve nga të dyja aeroportet

Alper Ersoj, drejtor i përgjithshëm i "TAV Maqedonia". Ashtu siç është rritur numri i udhëtarëve, Ersoj thotë se është rritur edhe numri i fluturimeve nga të dyja aeroportet. "Paralelisht siç është rritur numri i udhëtarëve, është edhe numri i fluturimeve nga Aeroporti

i Shkupit dhe Ohrit për 7 për qind apo gjatë vitit 2017 janë realizuar gjithsej 18.130 fluturime", thotë Ersoj. Ndërsa sa i përket se drejt cilave destinacione më së shumti kanë udhëtarë qytetarët e Maqedonisë gjatë vitit 2017, Ersoj informoi se më shumë udhëtarë nga Maqedonia kanë fluturuar drejt aeroportit të Stambollit dhe Cyrihut. "Gjatë vitit 2017 si destinacione me të frekuentuara nga aeroporti i Shkupit janë aeroporti

Ataturk dhe Sabiha Gokçen në Stamboll me 12.3 për qind, Cyrihu 8.6 për qind, Vjena 6.5 për qind, Bazeli me 5.3 për qind, Ime 4.6 për qind dhe Londra me 3.7 për qind", tregoi drejtori i "TAV Maqedoni". Sa i përket se cila kompani ajrore ka marrë më shumë pjesë në bartjen e udhëtarëve gjatë viti 2017, Ersoj tha se rreth 60 për qind e udhëtarëve kanë fluturuar me kompaninë ajrore "Vizz Air". Në ndërkohë, muaji gusht ka qenë më i ngarkua-

ri me udhëtime. "Në muajin gusht kanë udhëtarë 8283 qytetarë përmes 98 fluturimeve si rezultat i Super Kupës të UEFA-së, ndërsa në këtë muaj janë shërbyer 216.409 udhëtarë apo rritje prej 23.7 për qind në nivel vjetor", thotë Alper Ersoj, drejtor i përgjithshëm i "TAV Maqedoni". Përveç rritjes së numrit të udhëtarëve dhe hapjes së linjave të reja ajrore, viti 2017 për "TAV Maqedoni" ishte i suksesshëm për shkak se SkyTrax - agjencia ndërkombëtare për shqyrtim dhe vlerësim të linjave ajrore për të tretën herë radhazi pas vitit 2015 dhe 2016 - aeroportin e Shkupit e ka radhitur në mesin e 10 aeroportëve më të mira në Evropën Lindore. Për momentin, nga aeroporti i Shkupit mund të fluturohet në 36 destinacione të ndryshme dhe 11 kompani ajrore i ofrojnë këto shërbime. Nga aeroporti i Ohrit kas tre linja të rregullta dhe 4 linja plotësuere charter gjatë sezonit të verës. Në vitin 2018 "TAV Maqedoni" paralajmëron hapjen edhe tre linjave të reja ajrore gjatë këtij sezoni veror dhe atë nga Varshava e Polonisë, Talini i Estonisë dhe Ajndhoven i Holandës.

# Grykësia për ledine



Nga  
Valbona MEHMETI

Dhe gjersa qeveritarët i gjejnë saora paratë nga buxheti për "zyrtarizimin e mëtejme me kravata", janë qindra fëmijë kosovarë që vuajnë urie për bukë. Por shteti "nuk gjen" as mjete as kohë të merret me ta. "Ka disa herë në shitore më shohin kinse për karamela/por kaçurrelja kur t'më shikojë dal dhe në gjana tjera/ma nep këte, ma nep ate, edhe këte, edhe ate...". Janë këto disa nga vargjet e një kënge të mirënjohur të artistit Muharrem Qena. Kënga është e vjetër, por këndohet me ëndje edhe nga të rinjtë. Me siguri nuk do të mungojë as në ahengjet festive të natës që shënon kapërcimin në motin e ri. Personazhi i këngës mund të ketë qenë i imagjinuar apo ndoshta ishte vetë autori. Kjo ka pak rëndësi. E rëndësishme është që kënga u ka mbijetuar viteve dhe ka flladitur shpirtin e shumë brezave. Për ta impresionuar shitësen me kaçurrela që e adhuronte, djali supozohet se nuk i ka mbetur borxh dyqanit për gjësendet që ka marrë.

Në realitetin e sotëm kosovar është një personazh publik që sikurse djali i këngës ka shumë kërkesa kur hyn nëpër dyqane. Dhe ajo nuk hyn në to për të shikuar ndonjë kaçurrele. As për karamela. "Mi jep këto këpucë për djalin, ato këpucë për vajzën... këto... edhe ato, edhe këto këtu... për vete", i thoshte ajo shitëses së re në moshë këtë dhjetor, në një nga dyqanet më të shtrenjta të këpucëve në Kosovë. Shitësja ia bën gati pakot dhe kur merr t'ia llogarisë shumën që duhet paguar stepet nga fjalët e klientes ekstravagante. "Tregojtu shefave tu kush i ka marrë", i thotë, dhe largohet pa paguar me qeset e mbushura me pesë palë këpucë. Një grua e tronditur me ngjarjen që sheh i drejtohet shitëses me sy të zgurdulluar: "Pse moj e le me dalë pa pagu?". Shitësja rrudh supet, pa mundur të nxjerrë dot fjalë nga goja. Kjo grua që ka vite që është bërë tmerr i dyqaneve e besa edhe i ordinancave private shëndetësore, është gruaja e një zyrtari të lartë shtetëror. "Blerja" e fundit është cikërimë krahasuar me "blerjet" e tjera luksoze që i rrëfejnë për të pronarë biznesesh. Sikur të mos ishte gruaja e një të fuqishmi në politikë, me siguri që nuk do të zinte vend në këtë kolonë. Veprimet e saj marrin vëmendje në publik, sepse është pikërisht statusi shoqëror i bashkëshortit që po ia jep asaj "imunitetin" për "të vjelë" mallra në dyqane sikur frutat në pemë. Deri më tani nuk është ra-

portuar se ndonjë pronar biznesi e ka lajmëruar në polici. Arsyet mund të merren me mend.

Arrogancë e superioritet në publik shfaqin edhe gra e fëmijë të politikanëve të tjerë. Sjelljet e tyre nxisin neveri te qytetarët dhe vetëm sa ua konfirmojnë se kulturën e zhvatjes së parasë së shtetit dhe të popullit përveç në institucione pushtetarë e kanë etabluar edhe në familjet e tyre.

\*\*\*

Ka shumë anekdota për të folmen e prizrenasve që nën ndikimin e turqishtes në shqipë e vënë theksin në fjalë aty ku nuk duhet. Në përpjekje për të ngushëlluar një bashkëbisedues se ka gjëra edhe më të këqija se ato që i kishin ndodhur prizrenasi i thotë "o kazi mazi". Të mësuar të jetojnë me hajni, korrupsion dhe haraç tenderësh në gjithë këto vite të pasluftës, deri para disa ditësh ekzistonte përshtypja se kosovarët më nuk mund t'i trazojë asnjë skandal qeveritar. Por disa vendime që mori Qeveria në 100-ditëshin e parë i tronditën jo pak kosovarët. Ua dëshmuar se paska "zi e ma zi", siç ka dashur të thotë prizrenasi. Vendimi i kundërligjshëm i kryeministrit për t'ia rritur pagën vetes dhe vartësve të tij dëshmoi se as kjo Qeveri nuk ndryshon nga ato të mëparshmet kur është çështja e përfitimeve persona-

le nga buxheti i shtetit. Kulmin e shënoi arsyetimi i kryeministrit se i duhet pagë më e madhe edhe për të "blerë këmishë e kravata". Disa të rinj iu përgjigjën me një aksion simbolik, por shumë domethënës, duke ia varur në rrethojat e ndërtesës së Qeverisë qindra kravata si donacion i mbledhur nga qytetarët. Të pranishmit në aksion me ironi shprehnin mllefin për vendimin që ua rrit beneficionet qeveritarëve në një kohë kur papunësia në Kosovë sillet në rreth 40 për qind, ndërsa rreth pesë për qind e popullatës jeton në varfëri ekstreme.

Vendimi ka nxitur reagime edhe të sindikatave të pavarura të punëtorëve të sektorit publik dhe, sipas deklaratave të përfaqësuesve të tyre, janari i vitit të ri mund të sjellë protesta e trazira sociale.

\*\*\*

Dhe gjersa qeveritarët i gjejnë saora paratë nga buxheti për "zyrtarizimin e mëtejme me kravata", janë qindra fëmijë kosovarë që vuajnë urie për bukë. Por shteti "nuk gjen" as mjete, as kohë të merret me ta. "Nuk gjen" as për 200 të rinj të uritur për dije, të cilët janë identifikuar nga instituti "Atomi" si persona me inteligjencë dhe aftësi të jashtëzakonshme në fusha të ndryshme. Nga mungesa e fondeve këta fëmijë, që në shtetet e zhvil-

**Arrogancë e superioritet në publik shfaqin edhe gra e fëmijë të politikanëve të tjerë. Sjelljet e tyre nxisin neveri te qytetarët dhe vetëm sa ua konfirmojnë se kulturën e zhvatjes së parasë së shtetit dhe të popullit përveç në institucione pushtetarë e kanë etabluar edhe në familjet e tyre**



luara trajtohen si pasuri kombëtare, nuk po mund t'i mbajnë as ligjëratat e kurset që do të avancojnë njohuritë e tyre. Investimi i shtetit në ta do të ishte investim në një brez që në të ardhmen e afërt do t'i kontribuonte zhvillimit dhe avancimit të shkencës dhe ekonomisë në vend. Por klasa aktuale politike nuk ka as vizion, as vullnet për investime, rezultatet e së cilave nuk shihen aty për aty. Sepse u shkojnë për shtati investimet afatshkurtra nga të cilat më shumë përfitojnë vetë sesa shoqëria. Përkrahja e këtyre të rinjve të talentuar është domosdoshmëri nëse nuk duam "rrjedhjen e trurit" nga vendi dhe vazhdimin e lulëzimit të injorancës. Kosova sot nuk ka nevojë për të rinj që shesin trimëri me armë. Ka nevojë për të rinj kreativë si atomistët që kanë ëndrra dhe ambicie për të ecur krahas botës së përparuar. Këto ëndrra nuk mund t'ua vrasë askush. As këta politikanë të cilëve 2017-a ua shpërfaqti "për ledine" grykësinë për pushtet e para. Kushedi edhe sa befasi zhvatjeje ia ka përgatitur për 2018-n ky kabinet qeveritar "dyqanit" të quajtur Kosovë. Na mbetet vetëm të urojmë që pushteti dhe grykësia e tyre (edhe e familjarëve të tyre) të mos e kenë jetëgjatësinë e këngës për kaçurrelen dhe karamelet. (koha.net)

## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goe Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përtheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e martë 9 janar | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006

Drejtor: Lirim DULLLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 221 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLLOVI - Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

# Viktor Orbani përdredh faktet



Nga  
Bernd RIEGERT

**M**e intervistën e tij në gazetën bulevardeske gjermane "Bild" kryeministri hungarez Viktor Orbani i shpalli edhe një herë luftë BE-së. Orbani ngul këmbë që ai nuk duhet ta respektojë vendimin e Gjykatës Evropiane, që e konsideron si "të dëmshëm". Kjo është gabim. Natyrisht që Hungaria, Polonia si dhe të gjitha vendet e tjera anëtare të BE-së duhet t'i zbatojnë këto vendime.

## FAKE NEWS TË NJË POPULISTI

Në rast të kundërt do të merrte fund baza ligjore, që është themeli i BE-së. Një bashkim që nuk respekton të gjitha parimet ligjore nuk mund të jetë i tillë. Këtë e di edhe Viktor Orbani. Argumenti i tij se vendimi që e detyron një vend anëtar që të pranojë refugjatë nga Italia dhe Greqia në kuadër të shpërndarjes së tyre brenda BE-së, nuk ka më vlerë, është i gabuar. Vërtet që vendimi i Gjykatës Evropiane për shpërndarjen e refugjatëve që i kufizuar për dy vjet dhe afati përfundoi në shtator 2017. Megjithatë ky



**Populisti hungarez Orbani refuzon të gjitha format e migrimit dhe nuk u qëndron besnik ligjeve të BE-së. Kjo nuk mund të vazhdojë kështu**



vendim duhet zbatuar. Ky është të paktën gjykimi. Këtë e di edhe Viktor Orbani. Megjithatë ai pretendon në gazetën "Bild" një gjë tjetër. Këto janë fake news të një populist.

Refuzimi i Hungarisë që të mos pranojë refugjatë të besimit mysliman, sepse ata janë të gjithë "pushues" është marrëzi. Fjala është për azilkerkues të luftës civile nga Siria dhe persona për të cilët në Itali dhe Greqi është vendosur që kanë të drejtë azili në BE. Vetëm këta janë

pjesë e programit të shpërndarjes. Po ashtu tani është fjala vetëm për disa qindra syresh. Orbani i di këto. Por me deklaratat e tij populiste ai fiton pikë të popullsisia hungareze, e cila me sa duket është kundër myslimanëve. Por kryeministri hungarez i fut me dashje në një torbë të gjithë refugjatët dhe emigrantët ilegalë dhe e refuzon pranimin e tyre në përgjithësi. Edhe ky është populizëm. BE-ja dhe Gjykata Evropiane nuk e detyron Hungarinë të pranojë

refugjatë që nuk kanë shans për azil, por vetëm për ata që u është njohur statusi i azilantit.

## SËRISH DISKUTIME

Interpretuesi i gabuar i fakteve kërkon tani një diskutim të ri. Në këtë pikë ai ka të drejtë. Në BE po diskutohet prej dy vitesh për reformimin e procesit të pranimit dhe të shpërndarjes së azilkerkuesve në BE. Deri tani këtë e bllokojnë Hungaria, Polonia, Çekia dhe Sllovakia. Interpretuesi i gabuar i fakteve, Orbani, kërkon tani diskutime të reja. Me këtë ka të drejtë. Në BE po diskutohet prej dy vitesh për procesin e azilit dhe të shpërndarjes së refugjatëve. Por deri tani këto diskutime i bllokojnë Hungaria, Polonia, Sllovakia dhe Çekia. Viktor Orbani e kupton fjalën solidaritet vetëm ku është në interesin e tij. Si p.sh. në rastin e ndihmave financiare që merr nga BE-ja. Ky vit ofron një mundësi të mirë për diskutime, sepse në verë BE-ja nuk do të diskutojë vetëm për politikën e migrimit, por edhe për kuadrin financiar. Dhe pas bisedimeve dhe grindjeve dikur do të merret edhe një vendim. (DW)

# Harku i Gjykatës Speciale...



Nga  
Pandeli MAJKO

**N**ë Prishtinë po luhet një politikë e cila po shkon drejt absurdit. Kërkesa për anulimin e Gjykatës Speciale po prodhon paqartësi dhe frikë për të ardhmen. Për arsye që kishin kuptim, hyja tek ata që kishin rezerva për krijimin e Gjykatës Speciale për krimet në Kosovë. Arsyetimi nuk qëndronte në mohimin e asaj që ndodhi në Luftën e Kosovës. Ai kishte të bënte me dallimin e përmbajtjes së akteve që serbët dhe shqiptarët kryen kundër njëri tjetrit, sidomos në periudhën e pasluftës. Në këtë histori dallimi i aksionit dhe reaksionit është i rëndësishëm. Ky dallim nuk mund të mbyllet me shprehjen se "krimi është krim, në çdo rast" (!). Edhe kodet penale më moderne e bëjnë dallimin. Aktualisht, në politikën e Prishtinës kanë filluar, me dhe pa të drejtë, të diskutojnë "drejtësinë" dhe raportin e vështirë historik që krijon Gjykata Speciale për shtetin e Kosovës.

Pyetja është, se pse ajo që refuzohet sot, nuk u diskutua dje kur kishte kohën?! Kjo dhe pyetje të tjera



kanë kuptim më shumë se sa dhënia e përgjigjeve. Diskutimi që duhej zhvilluar dikur... tani ka një kontekst tjetër. Bllokimi i Gjykatës Speciale po shikohet nga ndërkombëtarët si prishje e një marrëveshjeje ndërkombëtare. Vota për krijimin e Gjykatës Speciale nga Kuvendi i Kosovës nuk ishte një akt "i brendshëm" i sistemit legal të shtetit. Ajo angazhoi Gjykatën e Hagës në një raport zyrtar me shtetin e Kosovës. Edhe për këtë arsye, kjo kontratë ndërkombëtare me emrin "Gjykata Speciale" u shoqërua me ndryshimin e Kushtetutës.

Të gjithë partnerët e Kosovës po bëjnë thirrje sot që të mos vazhdohet në këtë drejtim absurd. Ai do të vendosë shtetin e Kosovës nën akuzë. Dhe ajo, nuk do ti ngajë deklaratimeve të përgjithshme që harrohen nesër. Akuza do fokusohet edhe tek persona të përveçëm të cilët do të izoloohen. Dhe ky do të jetë vetëm fillimi. Jam i bindur se dikush që ka qenë i gatshëm të japë jetën në Luftë, nuk do ti frikësohej asnjë akuze të pabazuar. Shteti i Kosovës nuk është një çështje personale. E kundërta është e vërtetë. E drejta shtetërore nuk diskuton asnjë fat per-

**Kosova fitoi Luftën. Tani duhet të fitojë paqen... me veten. Paqja e Kosovës kalon nga harku i Gjykatës Speciale. Harku i saj nuk ka triumf. Ai do të masë karaktere njerëzish më shumë se sa drejtësinë. Sigurisht!**



sonal. Vendosja e interesit shtetëror mbi fatet e personave, dallon burrat e shtetit nga njerëzit e vegjël. Kush mendon se SHBA, Britania e Madhe dhe Bashkimi Europian do ta përtypin në heshtje një vendim "sovrani" për pezullimin e Gjykatës Speciale, gabohet.

Amerikanët, sidomos ata, si miq, të duan deri në tejkalim të marrëdhënies shtetërore. Mos e dhëntë zoti, ti kesh përballë si tradhtarë të besimit të miqësisë... Me ish-ushtarin e Luftës ata sillen me rregullat e respektit ndaj tij. Ndaj pabesisë nuk kanë rregulla. Pa dallim! Me shpresë dhe besim uroj që viti 2018 të sjell reflektim në emër të së ardhmes së shtetit të Kosovës për këtë çështje. Në marrëveshjet ndërkombëtare ku vihet në diskutim statusi i shtetit, pendesa nuk ekziston.

Kosova fitoi Luftën. Tani duhet të fitojë paqen... me veten. Paqja e Kosovës kalon nga harku i Gjykatës Speciale. Harku i saj nuk ka triumf. Ai do të masë karaktere njerëzish më shumë se sa drejtësinë. Sigurisht!



## Populli që po shuhet nga kanceri!

Në Papua Guinea praktikohet një traditë të çuditshme e përtypjes së arrave betel, e cila ka rritur rastet e kancerit të gojës, sëmundje kjo e cila po merr shumë jetë në këtë vend. Kjo traditë sot praktikohet nga gjithë populli, ndërsa më herët bëhej vetëm në raste të veçanta festash. Por, tani rastet e kancerit të gojës, të cilat po rriten dita ditës, po bëjnë që kombi të

përpiqet të kontrollojë varësinë e tij ndaj kësaj tradite të keqe. Kjo traditë aplikohet shumë te fëmijët e moshës gjashtë vjeç, ndërkohë që ata të cilët kanë krijuar varësi pranojnë se e përtypin arrën betel nga mëngjesi deri në darkë. Në Papua Guinea e Re, ku është e njohur në vend si "Buai", konsumohet me një shkop mustardë të zhytur në pluhurin e shkrirë të

gëlqeres, dhe kjo këta persona i bën të lumtur dhe u jep energji, pas lodhjes së madhe me punët. Papua Guinea e Re ka shkallën më të lartë të kancerit të gojës në botë. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, gati një në çdo 500 raste të reja të gojës dhe kancerit të fytit është në Papua Guinea e Re duke u bërë vrasësi më i madh në vend.







## ECJA NËPËR AKULLE E VETËVENDOSJES

Dilemat aktuale janë nëse të ata që dhanë dorëheqje dhe mbështetësit e tyre do të rikthehen në parti apo do të vendosin të themelojnë një fraksion politik të veçantë, jashtë strukturave aktuale. Të dyja opsionet, po konsiderohen të vështira për ecjen më tutje të këtij subjekti politik, i cili viteve të fundit kryesisht ka qenë zëri më i fuqishëm opozitar në Kosovë

Subjekti më i madh opozitar në Kosovë, Lëvizja Vetëvendosje, aktualisht po përballlet me probleme të brendshme, përçarje e mospajttime. Nga postet e larta drejtuese, tashmë kanë dhënë dorëheqje personalitete të njohura politike duke përfshirë kryetarin Visar Ymeri, nënkryetarin Dardan Sejdiu dhe anëtarë tjerë të këtij subjekti politik. Dilemat aktuale janë nëse të ata që dhanë dorëheqje dhe mbështetësit e tyre do të rikthehen në parti apo do të vendosin të themelojnë një fraksion politik të veçantë, jashtë strukturave aktuale. Të dyja opsionet, po konsiderohen të vështira për ecjen më tutje të këtij subjekti politik, i cili viteve të fundit kryesisht ka qenë zëri më i fuqishëm opozitar në Kosovë. Fatmire Kollçaku, nënkryetaria e vetme aktualisht e Lëvizjes Vetëvendosje, tha për Radion Evropa e Lirë se ka disa probleme në parti, por siç tha ajo, ato janë të kalueshme. "Nëse ka mospajtime ato duhet të diskutohet ballë për ballë. Unë mendoj se ka shumë hapësirë që të tejkalohen përmes ofrimit të zgjidhjeve. Si çdo subjekt, që kohë pas kohe ka sfida, sidomos në kohën kur (subjekti politik) rritet shumë, mund të ketë mendime ndryshe,

por unë mendoj se megjithatë, përmes bisedës së sinqertë mes bashkë-aktivisteve çdo gjë është e mundur dhe unë janë optimiste në këtë drejtim dhe besoj se gjithnjë ka mundësi që të tejkalohen mosmarrëveshjet dhe të vazhdojmë bashkë", tha Kollçaku.

Përderisa kryetari i deritashëm i këtij subjekti politik Visar Ymeri kishte arsyetuar dorëheqjen e tij me pamundësinë e ndryshimeve brenda vetëvendosjes për shkak të dallimeve të mëdha, nënkryetaria Kollçaku, beson se nuk ka përçarje, por mospajttime. Ajo ka përjashtuar mundësinë e krijimit të fraksioneve. "Në këtë moment unë nuk shoh fraksione. Unë ende besoj se janë mosmarrëveshje, por që janë të kalueshme dhe koha do ta tregojë", tha Kollçaku. Ndryshe, javën e kaluar, sipas zyrtarëve të Vetëvendosjes në mbledhjen e Kryesisë së këtij subjekti politik është marrë vendim që të gjithë anëtarët që kanë dhënë dorëheqje nga Kryesia, të shqyrtojnë vendimin e tyre për t'u rikthyer. Deputetja Albulena Haxhiu, në një postim në profilin e saj në rrjetin social Facebook, ka shkruar pikërisht rreth zhvillimeve brenda Vetëvendosjes. "Gjatë kësaj kohe Lëvizja ka kaluar në periudha jo të

lehta dhe qytetarët në forma të ndryshme na kanë shprehur shqetësimet e tyre mbi atë çfarë po ndodhë në Lëvizje. Meqë jemi duke kaluar këtë periudhë jo të lehtë, është e qartë se sfidat nuk rregullohen duke hequr dorë, por duke u angazhuar drejtpërdrejtë e aktivisht", ka shkruar pos tjerash Haxhiu. Në anën tjetër, analistët politikë konsiderojnë se problemet e brendshme të cilat e kanë përfshirë Lëvizjen Vetëvendosje, janë të mëdha dhe se sipas tyre, ato e kanë dëmtuar në masë të madhe këtë subjekt politik. Analisti Artan Muhaxhiri, vlerëson se procesi i çarjes, siç e quan ai në Lëvizjen Vetëvendosje, ka kaluar në një fazë serioze. Ai thotë se përmirësimi ose kthimi i gjendjes së mëhershme është i pamundur. "Nga asnjëri tabor nuk ka vullnet për kompromis, sepse të dyja palët këmbëngulin në qasjen e tyre të vazhdimësisë së Lëvizjes Vetëvendosje dhe për fat të keq të Lëvizjes Vetëvendosje, duket se kjo çarje do të thellohet deri në ndarjen përfundimtare", tha Muhaxhiri. Në cilëndo formë, thotë Muhaxhiri, Vetëvendosje është dëmtuar dhe ajo do të ketë shumë punë për të përmirësuar imazhin negativ që e ka shfaqur kohëve të fundit. "Në

momentin kur problemet fundamentale dalin në publik, atëherë kjo e ndryshon edhe perceptimin e përgjithshëm, por edhe i zvogëlon mundësitë për përafrim dhe kjo ka ndodhur në Lëvizjen Vetëvendosje. Të gjitha këto beteja publike kanë një kosto të madhe dhe kjo do të jetë kështu edhe nëse ndahet Vetëvendosje, edhe nëse kthehen të pakënaqurit", tha ai. Përplasjet në Vetëvendosje, dolën në sipërfaqe pas publikimit të bisedave private mes disa deputetëve të këtij subjekti politik, ku kishite edhe shprehje fyese në drejtuara ndaj Albin Kurtit. Nga postet e larta drejtuese të Lëvizjes Vetëvendosje kanë dhënë dorëheqje ish-sekretari organizativ Dardan Molliqaj, pastaj Aida Dërguti si dhe kryetari i saj, Visar Ymeri dhe nënkryetari Dardan Sejdiu. Vetëvendosje, tashmë ndodhet në procesin e brendshme zgjedhor. Deri me datën 10 janar është kohë e paraparë për t'u paraqitur kandidaturat e të interesuarve për kryetar të partisë. Deri me tash, sipas zyrtarëve në Vetëvendosje, është paraqitur vetëm një kandidaturë për kryetarin e ardhshëm, dhe ajo është kandidatura e Albin Kurtit, njërit prej themeluesve kryesorë të këtij subjekti politik. (REL)



### S'ka vizë, Haradinaj anulon vizitën në SHBA

Një zyrtar nga Garda Nationale në Iowa të SHBA-së i ka thënë Radios Evropa e Lirë se kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, e ka anuluar vizitën në këtë shtet me arsyen se "ai nuk ka mundur ta marrë vizën". Haradinaj pritej të merrte pjesë më 11 janar në një ngjarje të organizuar nga Komandanti i Gardës Nationale në Iowa, Timothy E. Orr. "Kryeministri Haradinaj ka qenë i ftuar nga gjenerali Orr në atë ngjarje, mirëpo është për keqardhje që ai nuk ka mundur ta marrë vizën dhe të jetë së bashku me ne", ka thënë kolonel Greg Hapgood, zëdhënës i gardës së Iowa-s. "Shpjegimi ka qenë se vizita nuk do të ndodhë tash në këtë kohë dhe nuk kemi marrë më shumë informata shtesë", ka shtuar ai. Sipas Hapgood, në vend të Haradinajt pritet të marrë pjesë zëvendëskryeministri Behgjet Pacolli. Por, Halil Matoshi, nga kabineti i kryeministrit Haradinaj ka thënë për Radion Evropa e Lirë se "e gjithë çështja është ende në procedurë". "Nuk e dimë, por nuk kemi konfirmim as po as jo". "E gjithë çështja është ende në procedurë. Kryeministri i Kosovës shkon në Iowa më 11 janar, prandaj ende presim, nuk kemi konfirmim nëse i është refuzuar apo do të jetë (v.j. i pranishëm në ngjarjen në Iowa), ka thënë Matoshi. Mediat në Prishtinë kanë raportuar të dielën se Ambasada Amerikane ia ka refuzuar kryeministrit Haradinaj vizën për të udhëtuar në SHBA. Vetë Haradinaj ka thënë se ende është duke pritur ta marrë vizën. "Pres edhe për vizë deri kur të ma japin. I besoj Kosovës! I besoj Amerikës! Jam ende në procedurë për vizë", ka shkruar Haradinaj të dielën në Facebook. Ky zhvillim pason kritikën e komunitetit ndërkombëtar pas përpjekjeve të ligjëvnësve të Kosovës për të ndryshuar ligjin për Cjykatën e Posaçme për Krime Luftë.

## NUK KA MARRËVESHJE PËR KOSOVËN ME GRABITËSIT SAJ

Mitropoliti i Kishës Ortodokse Serbe në Mal të Zi Amfilohije ka vazhduar në distancë polemikën me kryetarin e Serbisë Aleksandar Vučić rreth Kosovës. Ai ka theksuar se nuk ka asgjë personale kundër Vučićit dhe se çështja e Kosovës është çështje e fatit të popullit. Por ai ka folur edhe fjalë shumë të këqija për udhëheqësit e Kosovës duke thënë se kurrë nuk bërë marrëveshje me "ata grabitës" i ka quajtur. "Vučić është kryetar i Serbisë dhe përgjegjësia e madhe bie mbi supet e tij. Ai këtë përgjegjësi nuk ka të drejtë ta heqë nga vetja,



siç është tendenca tash. Kosova është çështje të gjithë neve. Po të mos kishte qenë Kisha, nuk do ta kishim pasur çlirimin e Kosovës në vitin 1912, as nuk do ta kishim ruaj-

tur Patrikanën e Pejës dhe Manastirin e Deçanit". Ka thënë se Kisha nuk e dënon askënd që paraqet qëndrim për Kosovën, porse vetëm shfaq shqetësimin për siç e ka

quajtur ai, "pjesën më të rëndësishme e më të ndritshme të shtetit serb". Ai e ka quajtur të papranueshme arritjen e çfarëdo marrëveshjeje detyruese me, siç i ka quajtur ai, udhëheqësit e Kosovës, "terroristët që e udhëheqin Kosovën e pushtuar". "Ata janë një grup grabitësish. Nuk janë madje as përfaqësues të popullit shqiptar, porse për qëllime të veta i kanë shfrytëzuar shtetet që e kanë bombarduar Serbinë e Malin Zi dhe i kanë instaluar në vende udhëheqëse në Prishtinë", ka thënë për ai portalin serb "in4s" mitropo-

lit Amfilohije, përcjell "blic". Ai thekson se me "të tillët nuk mund të ketë as ujdi e as marrëveshje dhe se shqiptarëve nuk mund t'iu jepet ajo nuk iu takon në asnjë mënyrë. Mitropoliti ka thënë se për Kishën Ortodokse Serbe është i papranueshëm çfarëdo marrëveshjeje që do ta rrezikonte sovranitetin dhe integritetin territorial të Serbisë. "Diçka të tillë nuk do ta pranojë askush i arsyeshëm te populli serb, e jam i sigurt as te shqiptarët, sepse e ardhmja e askujt nuk mund të ndërtohet në rrëmbime krim", tha ai.



## Ahmadinejad i në arrest shtëpiak

Ish-presidenti Iranian, Mahmud Ahmadinejad u arrestua në qytetin e Shirazit për nxitje të trazirave dhe protestave. Ahmadinejad është nën arrest shtëpiak, me miratimin e udhëheqësit suprem, Ajatollah Ali Khamenei. Ish-presidenti vuan pasojat e disa deklaratave të bëra gjatë një vizite në qytetin Bushehr në fund të dhjetorit, kur ai tha se Irani vuan nga "menaxhimi i keq" dhe se presidenti aktual Hassan Rouhani dhe qeveria e tij "besojnë se janë zotërit e një shoqërie injorante". "Disa liderë aktualë jetojnë të shkëputur nga problemet dhe shqetësimet e njerëzve dhe nuk dinë asgjë për realitetin e shoqërisë", ka thënë Ahmadinejad. Ndërkohë, parlamenti iranian është mbledhur të dielën me detyrë të mbyllura për të diskutuar lidhur me protestat e ditëve të fundit në disa qytete të vendit. Deputetët kanë dëgjuar ministrin e Brendshëm dhe atë të inteligjencës si dhe sekretarin e Këshillit Kombëtar Suprem për sigurinë. Disa prej tyre kanë shprehur shqetësime për kontrollin në internet të vendosur në fuqi gjatë trazirave, përfshirë ndalimin e aplikacionit Telegram, i cili është më i përdoruri në Iran. Sipas hetuesve ai është përdorur për të nxitur protestat dhe dhunën.

Në internet është inicuar një peticion për trajtimin e foshnjës Kasim nga rajoni i Gutës Lindore, i cili si pasojë e një sulmi të regjimit të Asadit ka mbetur jetim dhe ka marrë plagë të rënda në fytyrë

Në internet është inicuar një peticion për trajtimin e foshnjës Kasim nga rajoni i Gutës Lindore të rrethuar nga regjimi i Bashar Asadit në Siri, i cili si pasojë e një sulmi ka mbetur jetim dhe ka marrë plagë të rënda në fytyrë, raporton Anadolu Agency (AA). Rrëfimi i Kasimit dyvjeçar nga Guta Lindore ishte bërë i ditur për opinionin botëror më 30 dhjetor nga AA. Fushata e hapur në faqen Change.org me titullin "Trajtimi i foshnjës Kasim, i cili në moshë dyvjeçare u bombardua dhe iu copëtua fytyra", synon të arrijë të paktën 5000 nënshkrime. Deri më tani, peticioni ka arritur të tubojë afër 2.900 nënshkrime. Ndryshe, foshnja Kasim, njëlloj sikurse foshnja Kerim e cila u shndërrua në simbol të Gutës Lindore, ishte shënjestër e bombardi-

# PETICION PËR SHËRIMIN E KASIMIT TË VOGËL



meve të regjimit të Asadit në prehrin e nënës. Një sulm nga një avion i regjimit më 3 dhjetor e ndau Kasimin nga e ëma e tij. Ndërkaq, ai vetë mori plagë të rënda në pjesën e hundës dhe gojës, duke humbur nofullën e epërme, zgavrën hundore dhe indet e buzëve dhe faqëve. Kasimi mbeti për dy ditë nën

kujdes intensiv pasi që kishte humbur vetëdijen. Për Kasimin tani kujdeset i ati i tij, megjithatë, ai ushqehet me vështirësi, për shkak të të çarave të mëdha dhe frakturave në gojë dhe hundë. I ati Muhamed Kahvexhi e ushqen atë duke injektuar ushqime të lëngshme përmes një sonde të futur në ezofag për-

mes hundës. Kasimi i vogël përjeton dhimbje të mëdha kur lëviz fytyrën. Për shkak të dhimbjeve, ai nuk mund të flasë dhe e ka të vështirë edhe të flejë. Sikurse shumë fëmijë të tjerë, edhe Kasimi prej të evakuohet nga Guta Lindore në mënyrë që të operohet në ndonjë spital me pajisje të plota.

## Bannon tërhiqet: Djali i Trumpit, një patriot

Ish-shëfë strateg i Shtëpisë së Bardhë, Steve Bannon, është tërhequr pas stuhisë së ngritur për deklaratat e tij në librin e gazetarit Michael Wolff. Në një komunikatë, Bannon, thekson mbështetjen e tij për presidentin, e cilëson "Russiagate" një "gjueti shtrigash" dhe djalin e Trumpit, "një patriot dhe njeri të mirë", duke u shprehur se komentet e tij mbi takimin "e mundshëm" me rusët, i referoheshin Paul Manafort-it. Bannon kishte thënë se Trump Jr nuk ishte patriot pas takimit me emisarët rusë në "Trump Tower" gjatë fushatës elektorale.

Komentet e tij, shpjegon Bannon, "i keqardhur nga vonesa e



përgjigjes", ishin jo për Trump Jr, por për "Paul Manafort, një profesionist me përvojë në fushatë elektorale dhe një njohës i mënyrës se si operojnë rusët. Duhet të dinte se ata nuk janë të ndershëm, dinakë dhe jo miqtë

tanë". Pasi kishte lënë të kuptohej se ekziston një luftë e ftohtë mes SHBA-Rusi, Bannon thekson që "nuk ka pasur asnjë lidhje me rusët dhe se hetimet janë një gjueti shtrigash". Në fund, ish-strategu, i zgjat dorën Trump-it për të rilidhur marrëdhëniet personale, duke përcaktuar miliarderin "të vetmin kandidat që duhej të sfidonte dhe të mposhte aparatit e Clinton", si "njeriu i vetëm që deri tani ka bërë një sforcim global për të predikuar mesazhet e tij". Edhe tani, përfundo ai, është gati të mbështesë presidentin në përkushtimin e tij për ta "bërë Amerikën sërish të madhe".



## OKB e shqetësuar nga arrestimi i Ahed Tamimit

Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) e ka cilësuar si shqetësues arrestimin e 16-vjeçares palestineze Ahed Tamimi nga ana e Izraelit dhe gjykimin e saj në Gjykatën Ushtarake. "Duhet të kuptohet se është e nevojshme të respektohen të drejtat e njeriut. Jemi veçanërisht të shqetësuar nga arrestimi i fëmijëve dhe ne i kemi ndarë këto shqetësime", tha zëdhënësi i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Stephane Dujarric, në briefingun ditor për shtyp. Ndryshe më 19 dhjetor, forcat izraelite arrestuan Ahed Tamimin në një bastisje gjatë natës në fshatin Nabi Saleh të Bregut Perëndimor. Nëna e saj u arrestua menjëherë pas saj. Një ditë më vonë, forcat izraelite arrestuan edhe kushërirën e saj. Në vitin 2012, Bashkia Başakşehir e Stambollit i ndau asaj çmimin për kurajo Hanzala për kundërshtimin e ushtarëve izraelitë teksa këta po arrestonin vëllain e saj. Presidenti turk, Recep Tayyip Erdoğan, në atë kohë kryeministër, u takua personalisht me vajzën palestineze për të shprehur admirimin e tij për trimërinë e saj. Babai, nëna dhe vëllezërit e Ahedit vazhdimisht janë arrestuar nga autoritetet izraelite për kundërshtimin e tyre të ashpër ndaj okupimit të tokave palestineze nga Izraeli. Në burgjet izraelite ndodhen afër shtatë mijë palestinezë, prej të cilëve rreth 300 janë fëmijë.

Kate Ryan, drejtore e zyrës për mbrojtjen e lakuriqëve Flying Fox Campbelltown, deklaroi se lakuriqët për shkak të temperaturës së lartë kishin djegie

## Australi, i nxehti shkakton ngordhjen e qindra lakuriqëve



Temperaturat që këto ditë kanë shkuar deri në 45 gradë Celsius kanë çuar në ngordhjen e qindra lakuriqëve në Sydney të Australisë. Në Sydney, dy ditë më parë, termometri ka treguar 47.3 gradë Celsius, duke e bërë atë ditën më të nxehtë në atë rajon që nga viti 1939. Shtëpia mediale lokale Camden Adver-

tiser njoftoi se të dielën ishte regjistruar 45.1 gradë Celcius, e cila çoi në ngordhjen e më shumë se 500 lakuriqëve. Kate Ryan, drejtore e zyrës për

mbrojtjen e lakuriqëve Flying Fox Campbelltown, deklaroi se lakuriqët për shkak të temperaturës së lartë kishin djegie. Shërbimi për Informim, Shpë-

tim dhe Trajnimin e kafshëve të egra në Uellsin e Ri Jugor tha se vullnetarët ishin në terren dhe u kanë dhënë ujë lakuriqëve. Në këtë mënyrë, ata shpëtuan më shumë se 100 sosh. Megjithatë, qindra që ishin ngjitur në pemë nuk mbijetuan. Në shtator 2017, australianët u paralajmëruan për rrezikun e temperaturave të larta dhe të zjarreve në këtë sezon veror pas një nga dimrat më të thatë që kur ekzistojnë matjet zyrtare atje. Gjatë fundjavës ishte regjistruar edhe dita më e nxehtë në 79 vitet e fundit.

# E VETËVRARA E RATKO MLLADIÇIT!

Vetëvrasja e Ana Mlladiçit, është vetëvrasja e vetë Ratko Mlladiçit, e figurës së tij prej babai. Ana Mlladiç, nuk ishte vetëvrasë, ajo ishte vetëvrasë nga i ati i saj. Ana Mlladiç është e vetëvrasa e Ratko Mlladiçit. Mbase vrasja më e veçantë e një prej kriminelëve më të mëdhenj në Evropën e pas Luftës së Dytë Botërore

Nga Durim ABDULLAHU


Disa nga historitë më të rënda të qytetërimeve njerëzore, dëshpërimisht, mund të kuptohen vetëm përmes njohjes dhe analizimit të atyre pjesëve që përballë përmasave të tërësisë, duken si detaje periferike. Më 22 nëntor në Hagë, ish-komandanti i serbëve të Bosnjës, Ratko Mlladiç, u dënua me burgim të përjetshëm për krime lufte dhe gjenocid në Srebrenicë nga Gjykata Ndërkombëtare për krime lufte në Jugosllavi. Ai u dënua edhe për vrasje, torturë, dhunime, shfarosje dhe të tjera krime të rënda që gjyqtari Alphonso Orië, i klasifikoi si "më të rëndat që i njeh njerëzimi". Mbi të gjitha këto, emri i gjeneralit serb Mlladiç do të mbetet i lidhur gjithmonë me të qenit autor i masakrës së Srebrenicës, më e tmerrshmja në Evropën e pas-holokaustit.

Në mars të vitit 2016, po kjo gjykatë pati dënua me 40 vjet burgim Radovan Karaxhiç, presidentin e Republikës Serbe të Bosnjës gjatë luftës dhe partnerin kryesor të Mlladiçit në krime lufte. Në rastin e tij si kriminel, pati bërë shumë përshtypje maskimi i tij si mjek popullor nën emër të rremë dhe pamje krejt të transferuar, për t'i shpëtuar arrestimit. Ndërkaq, ata që kanë dashur të depërtojnë në psikologjinë e Ratko Mlladiçit, i kanë dhënë një vend kyç një vdekje të veçantë mes mijëra vdekjeve që e kanë rrethuar këtë gjeneral të ushtrisë serbe. "Një vdekje e vetme është krim, një milion vdekje është statistikë". Kjo shprehje e shumëcitur, e thënë nga një prej përgjegjësve të më së shumti vdekjeve në shekullin e



njëzet, Josef Stalin, bartë një të vërtetë të madhe por që ajo nuk e thotë. Vdekjet e miliona njerëzve, qëllon që vetëshpjegohen nga një vdekje e vetme. Lufta e Bosnjës dhe masakra e Srebrenicës si episodi më i tmerrshëm i saj, në përgjithësi janë të njohura bashkë me shoktarët dhe pasojat e tyre. Por përtej rreth 100.000 vdekjeve gjatë luftës në Bosnje dhe Hercegovinë, ka një vdekje që tregon aq shumë për kriminelin serb të luftës Ratko Mlladiç.

Më 25 mars 1994, agjencia e lajmeve "Reuters", njoftonte se "Ana Mlladiç, e bija e gjeneralit Ratko Mlladiç, u gjend e vetëvrasë natën e së enjtes duke gdhirë e premtë, në Beograd, në shtëpinë e prindërve të saj. Sipas policisë, e cila ndodhej ende në vendngjarje në mesditë, vajza e re kishte qëlluar veten me një plumb në kokë me armën e të atit. Ana Mlladiç ishte njëzet e tre vjeçe, studente në Fakultetin e Mjekësisë". Për shumë vjet, kjo vdekje do të bëhej temë e



shumë spekulimeve pasi që vetë i ati i të vdekurës, gjenerali Mlladiç kishte refuzuar ta pranonte atë si vetëvrasë duke këmbëngulur që e bija e tij ishte vrarë nga kundërshtarët politikë. Pushteti i Mlladiçit kishte bërë që versioni i tij për vrasjen e pretenduar të së bijës, të imponohej si i vërtetë ose si kinse i vërtetë për një kohë të gjatë.

Por dymbëdhjetë vjet pas këtij rasti, më 25 mars 2006, oficeri policor që kishte hetuar këtë rast kishte deklaruar për gazetën "Kurir" se pavarësisht asaj se çfarë duan të besojnë njerëzit, ai do ta thoshte të vërtetën duke thyer heshtjen e tij. Dhe e vërteta, ishte rezultati i hetimit në vendngjarje, në katin e dytë të shtëpisë së familjes Mlladiç, ku Ana ishte gjetur e vdekur në shtrat, me një revole në dorë. Ishte pikërisht kjo revole, ajo që sqaronte qëllimin e Anës dhe atë që e kishte çuar vajzën e re t'i jepte fund jetës së saj. Ajo ishte një 7.65 milimetërshe që Ratko Mlladiç e kishte marrë dhuratë nga Akademia Ushtarake e Komandës kur ishte graduar major. Sipas Bosa Mlladiçit, gruas së gjeneralit, krisma e plumbit që i kishte shpuar tëmthin të bijës, ishte dëgjuar në ora 6 të mëngjesit. Në shtëpi nuk kishte shenja të hyrjes së ndokujt. Përfundimi zyrtar i hetimeve policore: Ana Mlladiç ishte vetëvrasë! Hetimet e mëtutjeshme tregonin



**Ajo ishte një 7.65 milimetërshe që Ratko Mlladiç e kishte marrë dhuratë nga Akademia Ushtarake e Komandës kur ishte graduar major. Sipas Bosa Mlladiçit, gruas së gjeneralit, krisma e plumbit që i kishte shpuar tëmthin të bijës, ishte dëgjuar në ora 6 të mëngjesit. Në shtëpi nuk kishte shenja të hyrjes së ndokujt. Përfundimi zyrtar i hetimeve policore: Ana Mlladiç ishte vetëvrasë!**

që ajo i kishte përjetuar shumë rëndë akuzat e gazetave ndaj babait të saj për vrasjet në Bosnjë.

E tërë kjo histori, të cilës i janë kthyer sërish mediat për ta kujtuar tani pas dënimit të Ratko Mlladiçit, është rrëfyer me shumë mjeshtëri nga Lionel Duroy de Suduiraut, i cili e ka bërë këtë histori subjekt të një romani që ai e ka titulluar "Dimri i njerëzve". Në këtë libër të vitit 2012, misteri i vdekjes së Ana Mlladiçit, vjen e treguar nga Marku, një shkrimtar francez që pasi është divorcuar nga gruaja, ndërmer një udhëtim në Bosnje për të hulumtuar këtë rast me idenë për të shkruar një libër mbi të. Duke takuar njerëz që kishin luftuar apo që kishin njohur gjeneralin Mlladiç dhe duke intervistuar ata që mund të ofronin ndonjë informacion për vajzën e tij, shkrimtari francez heton me shumë durim të vërtetën e njohur nga shumica por të pathënë për vetëvrasjen e Ana Mlladiçit.

Tregimet rreth jetës së familjes së gjeneralit, nxjerrin në pah që revolja me të cilën Ana kishte vrarë vetën, ishte arma më e preferuar e babait të saj, të cilën ai nuk e përdorte dhe të cilën e ruante për të shtënë me të ditën kur Ana do ta bënte gjeneralin gjysh. Por përse Ana kishte menduar të vetëvritej





pikërisht me këtë revole, që i ati e ruante ta shkrepnte kur ajo të bëhej nënë? Kjo kuptohet nga motivi i vetëvrasjes së saj. Ata që kishin qenë afër Anës në kohët e fundit para se të vritej, tregojnë që ajo ishte dëshpëruar shumë nga artikujt e gazetave evropiane që e quanin babain e saj "kasapi i Bosnjës".

Gazetat e pavarura evropiane e kishin rrënuar imazhin e Anës për babain e saj, duke e treguar atë si një frikakac, oportunist, një i çmendur i verbuar nga urrejtja që po aplikonte në Bosnjë me shumë zell planet për shfarosje në myslimanëve, të bëra nga diktatori Slobodan Millosheviç në Beograd dhe nga Radovan Karaxhiç në Palë. Vetëvrasja e Ana Mlladiçit kishte ngjarë vetëm gjashtë javë pas të shtunës së 5 shkurtit 1994, kur ushtarët e babait të saj gjeneral, kishin gjuajtur një predhë murtaje në tregun e Sarajevës në mes të ditës, duke vrarë gjashtëdhjetë e tetë njerëz e plagosur gati dyqind. Kjo masakër e qëllimshme kishte bërë aq jehonë ndërkombëtare, sa që shtypi serb nuk kishte arritur ta mbulonte me dezinformimet e tij. Lajmi kishte mbërritur në veshët e Anës dhe ajo kishte rënë në dëshpërim me hipokrizinë e të atit që gjithmonë kishte qenë modeli i saj për njeriun. Teoritë psikanalitike për personalitetin dhe psikologjinë e individit, na tregojnë se sa i rëndësishëm është raporti me babain, sidomos në raste kur ai idealizohet nga fëmijët. Rrënimi i figurës atërore, për Anën duhet të ketë qenë një goditje e papërballueshme, që e ka shtyrë atë drejt një vendimi të shpejtë, për tu hakmarrë ndaj babait mashtrues, duke e vrarë veten. Ana Mlladiç u vetëvra mbase jo se nuk donte më të jetonte, por se donte t'i hakmerrej të atit duke e zhbërë veten, me armën e tij të preferuar, që ai e kishte veçuar për ditën më të rëndësishme që do t'i bënte edhe më të forta lidhjet babë e bijë.

Vetëvrasja e Ana Mlladiçit, është vetëvrasja e vetë Ratko Mlladiçit, e figurës së tij prej babai. Ana Mlladiç, nuk ishte vetëvrasë, ajo ishte vetëvrasë nga i ati i saj. Ana Mlladiç është e vetëvrasa e Ratko Mlladiçit. Mbase vrasja më e veçantë e një prej kriminelëve më të mëdhenj në Evropën e pas Luftës së Dytë Botërore. I vlerësuar edhe nga kritika dhe i shqipëruar nga Krenar Hadëri, romani "Dimri i njerëzve" është një udhëtim që e shpjen lexuesin nga Banja Luka në Pallë dhe Sarajevë, mes kujtimeve të trishta, urrejtjeve dhe historive me plot gjak të boshnjakëve, serbëve e kroatëve.

Përmes rrëfimeve të atyre që dikur kishin luftuar për gjeneralin kriminel serb, të balancuara me historitë e pabesueshme të atyre që u kishin shpëtuar plumbave të këtyre të parëve por që kishin humbur shumë nga njerëzit përreth, Duroy ndërton një histori që duket shumë e kompletuar, për vdekjen ndoshta më të rëndësishme në jetën e Ratko Mlladiçit. Mes lokaleve të varfra që rëndojnë erë rakië e ku fotografia e Mlladiçit dhe guslla serbe qëndrojnë të varura bashkë nëpër mure për këngët heroike serbe, ruhen krejt natyrshëm dhe me fanatizëm historitë e mijëra vrasjeve të të dënuarit Ratko Mlladiç, që gjithë pjesën tjetër të jetës së tij do ta kalojë në burgun e Hagës. E vetmja "vrasje" e tij për të cilën kurrë s'do të ketë një këngë me gusëll, është vrasja e të bijës, Anës. Në jetëshkrimin e tij, Ana do të mbetet e vetëvrasa e Ratko Mlladiçit. (gazeta shqip)



# EVROPA NË RREZIK TË PËRMBYTET PREJ PLASTIKËS

Deri tani më shumë se gjysma e mbeturinave plastike të botës eskportoheshin për në Kinë, por Pekini vendosi tani t'i ndalojë ato. Aktivistët kinezë të mjedisit gëzohen, por Gjermania gjendet para një problemi



## PLEHRAT TË SËMURIN

Zona të tëra në Kinë jetonin deri tani prej seleksionimit të mbetjeve për nxjerrjen prej tyre të lëndëve të para. Familje të tëra punojnë dhe jetojnë në kushte të mjerueshme, në fushat e grumbullimit të plehrave. Në Guiyu, për shembull, një qytet në jug të Kinës, ku seleksionohen pajisje elektrike, mjekët kanë konstatuar nivele të larta plumbi në gjakun e 80 përqind të fëmijëve të ekzaminuar. Gjërat që nuk mund të riciklohen, derdhen shpesh në lumenj dhe në fusha dhe në fund përfundojnë tek frutat, primet apo ushqimet e tjera. Tani Pekini zyrtar vendosi ta ndalë importimin e mbeturinave nga Evropa. Me rritjen e mirëqenies në vend Kina prodhon tani vetë më shumë mbetje dhe po bëhet më e vetëdijshme për mjedisin. Kudo në të gjithë vendin po ndërtohen impiante moderne riciklimi dhe djegieje. Aktivistët kinezë të mjedisit po festojnë për

këtë sukses. Sipas tyre ky vendim i qeverisë është një kontribut për zgjidhjen e problemeve të rënda mjedisore të Kinës.

## PROBLEM PËR EVROPËN

Shumë vende, si Gjermania, nuk kanë më tani mundësi të eksportojnë 24 lloje mbeturinash që janë përfshirë në listën e importeve të ndaluara. Tani ato duhet të mendojnë për të gjetur shpejt alternativa, sepse BE-ja është në rrezik të përmytet prej mbeturinave plastike. Megjithë sistemin e ndarjes së plehrave dhe mbeturinave Gjermania është ende një nga prodhuesit më të mëdhenj të mbetjeve plastike në BE për shkak të mungesës së vetëdijes për këtë problem. Po ashtu në Gjermani si dhe në vende të tjera të BE-së koston për përpunimin e mbeturinave janë mjaft të larta dhe për këtë mendohet se një pjesë e madhe e tyre do të përfundojë përsëri në detra dhe oqeanë.



Marrë parasysh se njerëzit nën moshën 25-vjeçare kanë lindur pas Revolucionit të vitit 1979 që e themeloi Republikën Islamike, do të ishte e lehtë për Teheranin t'i përshkruajë protestat e tanishme si energji rinore, të njerëzve që janë shumë të rinj për të ditur më mirë. Por, një protestues 25-vjeçar mund të ketë arritur moshën madhore kur regjimi kishte reaguar në mënyrë të dhunshme ndaj protestave kryesisht paqësore të vitit 2009. Shumë nga ta me siguri kanë votuar në zgjedhjet e vitit 2013, kur u zgjodh pasrendësi i Ahmadinejadit, Hassan Rohani

Nga Frud BEZHAN

Disa ditë pas shpërthimit të protestave kundër Qeverisë iraniane, është ende e vështirë të thuhet me saktësi se kush janë protestuesit dhe çfarë saktësisht ata po synojnë të arrijnë. Protestave u mungon një zë qendror, po mbahen në vende të ndryshme e të mëdha, dhe po tërheqin një masë të gjerë të iranianëve, që e bën të vështirë karakterizimin e tyre bazuar në gjininë, grupmoshën ose klasën shoqërore. Kjo është krejtësisht ndryshe krahasuar me protestat masive të vitit 2009, që filluan pas rizgjedhjes së diskutueshme të Mahmud Ahmadinejadit. Ato protesta kanë pasur zanafillën në zemërimin ndaj asaj që është konsideruar si mashtrim zgjedhor, janë nxitur nga udhëheqësit opozitar të Lëvizjes së Gjelbërt, dhe janë përkrahur gjerësisht nga klasa e mesme e arsimuar e Teheranit. Edhe pse janë bërë krahasime me revoltën e vitit 2009, pesë ditë të protestave të tanishme tregojnë se ato nuk janë të njëjta me njëra-tjetrën. "Këto protesta nuk mund të cilësohen si ato të vitit 2009, të cilat regjimi kishte provuar t'i përshkruante si një 'fenomen i Teheranit verior', i aktivistëve ngatërruarë, të kamur e të shkolluar", thotë Scott Lucas, specialist i çështjeve të Iranit në Universitetin britanik të Birminghamit dhe redaktor i uebfaqes EA World Views. "Shpërndarja e protestës thuhet se është gjithë qytetet e Iranit tregon për një dyshim të gjerë ndaj asaj se çfarë po bën regjimi për ekonominë, politikën e jashtme dhe intervenimet ushtarake, dhe për çështje politike e sociale", shton Lucas.

# KUSH JANË PROTESTUESIT E IRANIT?



## PËRTEJ DEMOGRAFISË

Teherani ka tentuar që ta përshkruajë revoltën si protestë të të rinjve. Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Hossein Zolfaghari, ka thënë se 90 për qind e protestuesve të arrestuar në mbarë vendin, kanë qenë nën moshën 25-vjeçare. Por, edhe pse dëshmitë dhe pamjet nga protestat tregojnë se shumë nga pjesëmarrësit janë të rinj, do të ishte e thjeshtëzuar dhe e pasaktë të thuash se të rinjtë janë të vetmit që po protestojnë. Marrë parasysh se njerëzit nën moshën 25-vjeçare kanë lindur pas Revolucionit të vitit 1979 që e themeloi Republikën Islamike, do të ishte e lehtë për Teheranin t'i përshkruajë protestat e tanishme si energji rinore, të njerëzve që janë shumë të rinj për të ditur më mirë. Por, një protestues 25-vjeçar mund të ketë arritur moshën madhore kur regjimi kishte reaguar në mënyrë të dhunshme ndaj protestave kryesisht paqësore të vitit 2009. Shumë nga ta me siguri kanë votuar në zgjedhjet e vitit 2013, kur

u zgjodh pasrendësi i Ahmadinejadit, Hassan Rohani.

I cilësuar si më i moderuar, Rohani kishte fituar duke u zotuar se do të përmirësonte marrëdhëniet me Perëndimin, do të siguronte më shumë liri për iranianët, dhe do ta ringjallte ekonominë që ishte goditur nga recensionin. Rohani fitoi sërish në vitin 2017, kryesisht edhe për shkak të suksesit për aritjen e një marrëveshjeje me fuqitë perëndimore, lidhur me programin e diskutueshëm bërthamor të Iranit. Por, edhe pse si pjesë e marrëveshjes u siguroi heqja e sanksioneve të rënda, zhgënjimi për shkak të dështimit të Rohanit për të sjellur përfitime ekonomike është rritur. Është e kuptueshme që niveli i lartë i papunësisë dhe gjendja e vështirë ekonomike i godet rëndë gjeneratat e reja të vendit. Më shumë se 50 për qind e popullsisë është nën moshën 30-vjeçare, dhe derisa papunësia tek të rinjtë zyrtarisht është rreth 20 për qind, besohet se është në fakt

rreth 40 për qind. Por, të rinjtë nuk janë e vetmja shtresa e shoqërisë që është e pakënaqur.

"Ata njerëz që po marrin pjesë në protestë i takojnë të gjitha shtresave sociale, rajoneve dhe moshave," thotë Raman Ghavami, një analist iranian që po i përcjell protestat. "Të varfrit, klasa e mesme, dhe të kamurit po marrin pjesë. Edhe gratë po luajnë rol", thotë tutje Ghavami. Duke iu referuar disa pamjeve ku shihen forca të sigurisë që refuzojnë t'i arrestojnë protestuesit dhe po solidarizohen me ta, Ghavami thotë se "edhe disa forca të sigurisë po i refuzojnë urdhrat".

## JO VETËM NJË ÇËSHTJE PO I NIXITË PROTESTAT

Nuk është vetëm një shqetësim që po i nxitë protestat. Ato fillimisht shpërthyen në qytetin Mashhad më 28 dhjetor, ku njerëzit protestuan kundër rritjes së çmimit të ushqimeve bazike, siç janë vezët dhe mi-shi. Por, derisa protestat filluan të shpërndareshin nëpër vende të tjera, protestuesit e drejtuan zemërimin e tyre ndaj udhëheqësve politikë të Iranit, duke thirrur "vdekje Rohanit" dhe "vdekje [udhëheqësit suprem Ayatollah Ali] Khameneit". Disa protestues madje kanë bërë thirrje për rikthim të monarkisë, që ishte rrëzuar gjatë Revolucionit Islamik të vitit 1979. Disa protestues të tjerë kanë brohoritur slogane kundër politikave të jashtme të Iranit, përfshirë përkrahjen ndaj regjimit të presidentit sirian Bashar al-

Assad, që shihet nga disa si një veprim i padobishëm dhe i kushtueshëm. Analistët besojnë se protestat në Mashhad mund të jenë nxitur nga përçarjet e brendshme në sistemin klerik. Mashhad, që është qyteti i dytë më i madh në vend, është vendlindje e ish-kundërshtarit zgjedhor të Rohanit, klerikut konservator Ebrahim Raisi. "Disa njerëz të linjës të ashpër i mirëpritën protestat në fillim, por ajo çfarë ata mund të kenë shprehur se do t'i shërbente interesave të tyre afatshkurtra, duket të ketë nxitur pakënaqësi më të mëdha, që shkojnë më thellë", thotë Naysan Rafati, një analist në International Crisis Group. Thënë shkurt, ajo çfarë mund të ketë filluar si një tentim për të shtuar kritikën ndaj Rohanit dhe marrëveshjes së tij për armët bërthamore, ka zgjuar pakënaqësi të heshtura.

## ASNJË AUTORITET QENDROR APO LËVIZJE PRAPA PROTESTAVE

Për dallim prej protestave masive të vitit 2009 që janë udhëhequr nga Lëvizja e Gjelbërt opozitare - udhëheqësit e së cilës vazhdojnë të mbahen në arrest shtëpiak - nuk ka ndonjë udhëheqës apo lëvizje që qëndron prapa protestave të tanishme. "Protestat duket të jenë krejtësisht spontane, dhe për aq sa kuptoj, pa ndonjë udhëheqës", ka shkruar në Twitter Alireza Nader, një analist në Rand Corporation. Analistët thonë se mungesa e një autoriteti qendror do ta bëjë më të vështirë për Qeverinë që t'i ndalë protestat. "Mungesa e një udhëheqësie prapa protestave është bekim, por edhe mallkim për autoritetet iraniane: në njërin anë, Qeveria mund ta cilësojë mungesën e një organizmi të qartë si arsye për të shprehur se ato do të ndalohen së shpejti", thotë Rafati. "Në anën tjetër, shkal-la e gjerë e pakënaqësisë, si dhe kërkesat e ndryshme të ngritura nga protestuesit, e bëjnë më të vështirë për të bërë koncesione të prekshme që do t'i adresonin kërkesat e protestuesve".



ZYRTARIZIMI PRITET TË ENJTEN

# FINO, RIVAL I DUKËS PËR KREUN E FSHF-SË



Prej muajsh është përfolur se Bashkim Fino do të jetë një prej kandidatëve zyrtarë në zgjedhjet e ardhshme për kreun e Federatës Shqiptare të Futbollit. Për gazetën "Panorama Sport", ish-kryeministri foli në periudhën kur vetë presidenti Armand Duka e lakoi emrin e tij duke u përgjigjur për këtë gjë.

Në fjalën e tij për gazetën, deputeti socialist e la të hapur mundësinë e kandidimit, duke mos e mohuar diçka të tillë. Tashmë që është caktuar edhe data e zgjedhjeve, Fino pritet që ta deklarojë zyrtarisht kandidaturën e tij për postin e kreut të Federatës Shqiptare të Futbollit. Diçka e tillë pritet që të

ndodhë të enjten, në emisionin "Rubrika Sportive" në "RTSh". Deputeti i Partisë Socialiste pritet që të bëjë publik qëndrimin e tij në garën për postin e kreut të FSHF-së, si dhe platformën me të cilën do të futet në garë. Së fundmi, Fino është parë më shpesh në shkallët e stadiumeve, për të ndjekur ndeshjet e futbollit.

Deputeti i Partisë Socialiste pritet që të bëjë publik qëndrimin e tij në garën për postin e kreut të FSHF-së, si dhe platformën me të cilën do të futet në garë. Së fundmi, Fino është parë më shpesh në shkallët e stadiumeve, për të ndjekur ndeshjet e futbollit

shjet e futbollit. Edhe në të shkuarën, ish-kryeministri është parë shpesh i lidhur me sportin dhe mbështetjen e skuadrave që ai i simpatizon. Pritet që qoftë edhe për formalitetet dhe procedurë, Fino të propozohet nga të paktën një prej anëtarëve me të drejtë vote në FSHF.

Kujtojmë, në krye të Federatës së Futbollit të Shqipërisë, Armand Duka është nga viti 2002, ndërsa në vitin 2014 është rizgjedhur president i FSHF-së, duke mos pasur asnjë kundërkandidat. Për Dukën, ky ishte kandidimi i katërt për një mandat në shtëpinë e futbollit të Shqipërisë.

## Bilali zgjedh Durrësin

Shkup, 9 janar – Amir Bilali është transferuar te skuadra e Teutës nga Durrësi. Sipas asaj që arritëm të kuptojmë, Bilali me skuadrën e Teutës ka nënshkruar për gjashtë muaj me opsion që e njëjta të vazhdohet nëse të dyja palët ngelin të kënaqur. Qendërmbrojtësi nga Kërçova së fundmi ishte pjesë e skuadrës së Rabotniçkit me të cilët me marrëveshje të dyanshme prishi kontratën para kohe. Në anën tjetër, skuadra nga Durrësi ka angazhuar edhe një futbollist nga Maqedonia. Fjala është për mesfushorin Burhan Mustafafov. 23-vjeçari ka qenë pjesë e kombëtares U-21 të Maqedonisë, ndërsa ka gjetur marrëveshjen me drejtuesit e Teutës dhe pasditen e të martës ka zbarkuar në qytetin e Durrësit dhe bashkë me Bilalin do të udhëtojnë në Antalia të Turqisë për t'iu bashkuar pjesës tjetër të skuadrës. Mustafafov, në pjesën e parë të kampionatit, është aktivizuar me ekipin e Pobodës, ndërsa nga 18 ndeshje në total, ai i ka zhvilluar 13 prej tyre. (B.K.)



## Kuqezinjtë shpërngulen në Ohër

Shkup, 9 janar - Futbollistët e Shkëndijës kanë lënë dje Tetovën duke mbyllur fazën e parë të përgatitjeve dhe i kanë vazhduar të njëjtat në qendrën përgatitore në Ohër, ku do të qëndrojnë shtatë ditë. Pas matjeve dhe testeve mjekësore stafi teknik tanimë ka nisur implementimin e plan-programit për këtë fazë të përgatitjeve, ku theks i veçantë i kushtohet ngritjes së nivelit të forcës fizike. Nga klubi tetovar njoftojnë se kuqezinjtë në Ohër do të punojnë

nga dy herë në ditë, kombinuar në palestër për ngritje të peshave dhe terren. Trajneri Osmani më 12-të dhe 16-të janar ka paraparë ndeshje testuese brenda grupit. Risia më e re është i Ensar Luma, i cili është emër ri në ekipin e parë, pasi avancohet nga skuadra U1, ndërsa në Tetovë kanë mbetur Abdurahimi dhe Asani. Cekim, pas 18-të xhironëve të zhvilluara, Shkëndija gjenet në krye të tabelës me 46-të pikë, tetë më shumë se kampioni aktual Vardari.



## Synojmë që të ngjitemi sa më lartë

Shkup, 9 janar - Skuadra e FC Shkupi ka vazhduar me seancat stërvitore në kuadër të përgatitjeve për sezonin pranveror. Seancat siç dihet po zhvillohen në stadiumin në lagjen Gjorçe Petrov, ku do të qëndrojnë deri më 20 janar para se udhëtojnë për në Antali të Turqisë. Në qendrën përgatitore në Turqi, bardhekaltërit do të zhvillojnë edhe pesë ndeshje miqësore, ndërsa në mesin e kundërshtarëve do të jenë skuadrat e njohura si Karabag, Anzhi dhe Çernomorets Odesa. Ndryshe, atmosfera në kampin bardheblu është shumë e mirë,

ndërsa në mesin e futbollistëve po mbizotëron një atmosferë e shkëlqyer, atmosferë e cila dukshëm është përmirësuar pas ardhjes së sponsorit të ri, pronarin e "Grup Impex" Shefqet Demiri. Në anën tjetër, kapiteni Suad Zendeli ka folur për synimet e klubit dhe kundërshtarët që do të kenë në Antalia të Turqisë. "Me të vërtetë është kënaqësi të kesh asi lloj kundërshtari, pasi Karabagu është një pjesëmarrës në Ligën e Kampionëve. Do përballemi me Karabagun, Anzhi dhe Çernomorets. Do të matim forcat me skuadrat kualitative që do të

na shërbejnë edhe neve që të jemi në kampionat edhe më cilësor që shpresojmë të kapim ato vende që ne i prenatojmë ose i kemi vendosur si objektiv në kampionat. Besoj se ne nuk përcaktojmë vend por do të synojmë që të ngjitemi sa më lartë pse mos të shpresojmë edhe më shumë", tha për "Alsat-m", Zendeli. Ndërkohë, para se të shkohet në Turqi, FC Shkupi do të testojë forcat me të rinjtë e kësaj skuadre, në një miqësore më 14 janar, ndërsa katër ditë më vonë do të përballen me një skuadër kualitative para shkuarjes në Antalia.





Disa persona të ngarkuar me fushën e menaxhimit tek Interi duhet të godasin "kokën e kokës", pasi të mësojnë për 160 milionë eurot, që Barcelona mundi të paguajë për Koutinjon, nëse të gjitha variablat e përfshira në marrëveshje janë plotësuar. Vetëm pesë vjet më parë, në merkaton e dimrit 2013, braziliani e la "Giuseppe Meazza" për të shkuar te Liverpooli, vetëm për 13 milionë euro

# INTERI, KLUB I SPECIALIZUAR PËR TË GABUAR RËNDË NË MERKATO



Koutinjo i përkiste Interit për katër vjet e gjysmë, edhe pse në dy vitet e para qëndroi në Brazil, me huazim te Vasco da Gama, klubi i tij i origjinës. Nënshkrimi i shkëlqyeshëm i Barcelonës luajti vetëm 47 ndeshje me fanellën zikaltrë dhe në sezonin 2011-2012 kaloi gjysmën e dytë të sezonit me huazim tek Espanjoli. Me ekipin spanjoll luajti 16 ndeshje (të gjitha të La Ligas) dhe shënoi pesë gola, njësoj sa tek Interi. Por, Koutinjo nuk është shitja e vetme e viteve të fundit, që me kalimin e kohës ka rezultuar

e gabuar në aspektin sportiv dhe të lirë në aspektin ekonomik. Roberto Karlos, Pirlo, Bergkamp apo Ronaldo triumfuan gjatë një periudhe të gjatë në klubet e tyre të destinacionit, pas largimit nga Interi.

Italiani Pirlo pati një rast të ngjashëm me atë të Koutinjos. Pas tri sezoneve dhe dy transferimeve,

Interi e shiti atë te fqinjët e Milanit, për 18 milionë euro. Një sasi e rëndësishme parash për kohën (ishite lojtari i 18-të më i shtrenjtë i atij sezoni), por që përfundoi duke qenë një gjë e vogël për klubin "rossonero", ku mbeti një dekadë dhe fitoi dy Çampions.

Gjithashtu, spikatën në klubet e tyre përkatëse Roberto Karlos

dhe Dennis Bergkamp, në të dyja rastet gjatë 11 viteve. Braziliani arriti në vitin 1996 te Real Madridi dhe mbledhi një mori titujsh. Klubi i bardhë pagoi 500 milionë peseta për të, tani vetëm tre milionë euro. Ky lojtar shkoi në Madrid për pak më shumë se 270.000 euro në vit. Më shumë para kishte marrë një vit para klubi lombard nga

Bergkamp, i cili e shiti tek Arsenali për pak më shumë se 11 milionë euro, nënshkrimi i dytë më i shtrenjtë i atij sezoni.

Diçka më afër në kohë, shitja e Ronaldos, provoi, gjithashtu, një vendim të gabuar të Interit. Te zikaltrit, "Fenomeni" ka përjetuar skenën e tij më të keqe si futbollist, i dënuar nga një kalvari lëndimesh. Te Real Madridi shkoi pas ringjalljes në Kupën e Botës së zhvilluar në Japoni dhe Kore. 45 milionë euro e çuan atë në Bernabeu (Interi i kishte paguar Barcelonës 28 milionë euro, katër vjet më parë), pas "soap opera", që zgjati tërë muajin gusht. Ronaldo, gjithashtu, triumfoi në Madrid për një çmim të moderuar, duke pasur parasysh kushtet e tregut në atë kohë. Në dy verat e mëparshme, Real Madridi kishte paguar 60 milionë euro për Figon dhe 72 milionë euro për Zidanin. Pra, braziliani nuk ishte nënshkrimi më i shtrenjtë i asaj merkatoje në vitin 2002: Manchester Junajtedi shpenzoi një milion euro më shumë për të marrë Rio Ferdinand.

Publicitet

## Konte, ëndrra e madhe e Milanit

Nuk ka dyshime se menaxhmenti e Milanit tashmë është duke menduar se si ta organizojë të ardhmen e klubit, duke filluar nga trajneri. Ëndrra e kuqezinjve është Antonio Conte, por në kombinim janë edhe Roberto Mançini si dhe Gian Piero Gasperini. Xhennaro Gattuso është 40 vjeç. Një jetë e parë si luftëtar i Milanit dhe një e dytë, sapo ka filluar, në rolin e trajnerit. Me të ardhmen e pasigurt në stolin kuqezi, megjithatë, sepse në fund të sezonit klubi i Milanit mund të vendosë bast për dikë tjetër në këtë rol. Gjithçka do të varet nga performanca e pjesës së dytë të sezonit, natyrisht. Por, nuk ka dyshime se menaxhmenti e Milanit tashmë është duke menduar se si ta organizojë të ardhmen e klubit, duke filluar nga trajneri. Dhe kjo që nga momenti i shkarkimit të Montellës dhe promovimit të Gattusos. Ëndrra e madhe, siç

konfirmohet nga "Corriere dello Sport", mbetet Antonio Conte. Dhe nuk është diçka e re. Vazhdon të flitet për ish-trajnerin e Juventusit, ashtu siç flitet për Roberto Mançinin, aktualisht në Rusi, në krye të Zenitit, i cili në orët e fundit nuk ka përjashtuar një punësim të mundshëm si trajner i axurrëve. Në fokus, megjithatë, është edhe zgjidhja e befasishme: Gian Piero Gasperini. Arkitekti i Atalantës, i cili, pas vendit të pestë në kampionatin e fundit, po konfirmon në Serie A se është i mahnitshëm në Evropë. Tani, duket i mbushur me ëndrra edhe për finalen e Kupës Italiane. Do të ishte një kthim në Milanin e tij, pas përvojës së shkurtër, negative dhe kundërtënëse tek Interi (2011-2012). Një hakmarrje totale. Por kjo dhe për më shumë do të diskutohet vetëm në fund të sezonit. Të paktën deri në qershor, do të ecet përpara me Gattusos.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 pika 1 paragrafi 2 dhe 3, nenit 23 ndërsa në lidhje me nenin 14 paragrafi 2 i Ligjit për marrëdhënie pune tekst i pastruar (Gazeta Zyrtare e RM nr. 145/2014), nenit 82 paragrafi 1 3 dhe 4 i Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 103/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11 dhe 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14 dhe 135/14, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016 dhe 127/16) dhe në bazë të pëlqimeve të marra nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës nr. 12-11042/2 të datës 07.12.2017, drejtori i SHFK "Braça Milladinovci" – Strugë, publikon

SHPALLJE

Për plotësimin e vendeve të punës për kohë të caktuar të vitin shkollor 2017/2018 deri më 31.08.2018

Mësimi në gjuhën maqedonase

1. Një mësimdhënës të njohjes së religjioneve me 6 orë mësimore.
2. Një mësimdhënës të gjuhës frënge me 6 orë mësimore.
3. Një mësimdhënës të gjuhës angleze me fond të plotë të orëve.
4. Një mësimdhënës të edukatës muzikore me 11 orë mësimore.
5. Një mësimdhënës të inovacioneve me 4 orë mësimore.

Mësimi në gjuhën shqipe

5. Një mësimdhënës të gjuhës maqedonase me 17 orë mësimore.
6. Një mësimdhënës të gjuhës frënge me 10 orë mësimore.
7. Një mësimdhënës të edukatës fizike me 9 orë mësimore.
8. Një mësimdhënës të shkencave natyrore me 18 orë mësimore (zëvendësim për mësimdhënësen në pushim të lindjes).
9. Një mësimdhënës të biologjisë me 4 orë mësimore (zëvendësim për mësimdhënësen në pushim të lindjes).
10. Një mësimdhënës të aftësive për mbijetesë me 8 orë mësimore.
11. Një mësimdhënës të artit figurativ me 15 orë mësimore.
12. Një mësimdhënës të kimsë me 12 orë mësimore.
13. Mësimdhënës në paralelet për nevoja të posaçme arsimore.

Mësimi në gjuhën turke

14. Një mësimdhënës të gjeografisë me 4 orë mësimore.
15. Një mësimdhënës të historisë me 5 orë mësimore.
16. Një mësimdhënës të matematikës dhe fizikës me 11 orë mësimore
17. Një mësimdhënës të shkencave natyrore me 4 orë mësimore
18. Një mësimdhënës të edukatës fizike me 6 orë mësimore

Kandidatët prej numrit rendor 1 deri në numrin rendor 18 krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj duhet të përmbushin edhe kushtet e parapara në nenin 42, 77 dhe 80 të Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 103/08, 33/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/14, 116/14, 135/14, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016 dhe 127/16). Orari i punës së mësimdhënësve është me dy ndërrime. Ndërrimi i parë është prej ora 7,30, ndërrimi i dytë prej ora 13,10 ndërsa përfundon sipas numrit të orëve nga orari i orëve për vitin shkollor 2017/2018. Ditët e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte. Paga bazë e mësimdhënësve është 20.640,00 denarë ndërsa për mësimdhënësit me fond më të ulët të orëve pagesa është në përpjestim me numrin e orëve të orarit të punës.

Së bashku me lutjen kandidatët të parashtrajnë: Dëshmi për arsim të mbaruar përkatës në origjinal ose kopje të vërtetuar, certifikatë të shtetësisë. Shpallja zgjatë 5 ditë pune nga dita e publikimit. Zgjedhja do të realizohet në afat prej 45 ditëve nga dita e përfundimit të shpalljes. Dokumentet e nevojshme të parashtrohen në adresën e shkollës rr. Jovan Sterfanoski – Rile numër 4 Strugë. Kontakt telefoni 046-781-890. Dokumentet e pakompletuara dhe të parashtruaras pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë shyrtyrimit.

U. D Drejtor,  
Laura Shate

Në bazë të nenit 19 nga Rregullorja për mënyrën e kryerjes të ekskursioneve shkollore prej shkollave të mesme, SHMK Kiro Spanxhovi-Brko, Kavadar shpall:

### SHPALLJE PUBLIKE:

#### Për mbledhjen e ofertave për organizimin e ekskursionit shkollor final

1. Ekskursioni final për minimum 45 persona në drejtim Firenze-Montekatini-Veronë-Venecie-Lido di Jesolo për periudhën prej 5 ditësh, 3 net në muajin prill të vitit 2018.
2. Dokumentet e tenderit dhe programi për zbatimin e ekskursionit mund të tërhiqet nga arkivi i shkollës çdo ditë pune prej ora 07-15 apo të dorëzohet në e-mail.
3. Shpallja publike zgjatë 5 (pesë) ditë prej ditës së publikimit.
4. Për më shumë informacione në nurin e tel. 043 412-847

SHMK Kiro Spanxhovi-Brko Kavadar  
Rr. Shishka pn

**Z**idan, i cili e ka drejtuar Real Madridin në fitimin e dy titujve të "Champions League" dhe një kurore në La Liga, është nën presion në "Santiago Bernabeu". "Los Blancos" kanë mbetur 16 pikë pas liderëve dhe rivalëve të Barcelonës, pasi kanë fituar 9 nga 17 ndeshjet e kampionatit. Zidan, i cili ka qenë trajner që nga janari 2016, tha se ai e kuptonte se do të kishte kohë të kufizuar në krye të Real Madridit. "Zinedin Zidan nuk është më një lojtar te Real Madridi. Si i tillë, Zidan nuk ekziston më", tha ai për "France Football". "Tani flasim për Zinedin Zidan si trajner, që të ndërtojë një karrierë të re. Nuk jam i mbrojtur nga ajo që kam bërë si lojtar në këtë klub. E di që një ditë puna e trajnerit do të përfundojë te Real Madridi, prandaj jap maksimumin dhe bëj gjithçka që mundem për të qenë i suksesshëm. Unë i them vetes: nëse kam 10 ditë këtu, atëherë do t'i jetoj ato 10 ditë deri në maksimum. Nëse është 6 muaj, unë do t'i jetoj ato 6 muaj deri në maksimum. Nuk mendoj përtej kësaj. E di që nuk do të qëndroj trajner i Real Madridit për 10 vjet", shprehet Zidan.

Real Madridi është në formë të diskutueshme në La Liga, duke mos fituar tri nga katër ndeshjet e fundit të kampionatit, për të qenë i katërti në tabelën e klasifikimit. Por, Zidan, i cili fitoi La Ligan dhe Ligën e Kampionëve si një lojtar me Real Madridin, tha se aftësia e tij për të injoruar çdo presion të jashtëm ishte vendimtare. "Presioni i jashtëm nuk më prek, kam mbërthyer një mburojë rreth ve-

# NUK MË MBRON AJO QË KAM BËRË SI LOJTAR, JO TRAJNER I REALIT PËR 10 VITE

Trajneri i Real Madridit, Zinedin Zidan, ndjen se arritjet e tij si lojtar nuk u japin mbrojtje gjigantëve të La Ligas, duke këmbëngulur se ai nuk do të ishte në klub për 10 vjet

tes sime, asgjë nuk më shqetëson", shtoi ai. "Unë kam shumë përgjegjësi si trajner i Real Madridit, por kur të kthehem në shtëpi, e s'takoj trurin. E di se shumë trajnerë nuk janë në gjendje të heqin mendjen nga puna, por e kam këtë aftësi. Unë shkoj në shtëpi dhe ba-

shkohem me bashkëshorten time, ose me djemtë e mi, dhe shkoj të shoh ndonjë shfaqje, ose të ha darkë. Unë e ndërpres veten time nga puna, sepse kjo është theme-lore", deklaroi Zidan. Kujtojmë, Zinedin Zidan është zgjedhur "Trajneri i Vitit në Francë" nga revista

"France Football", për të dytin vit radhazi, pas vitit të suksesshëm 2017 me pesë trofe. Ai e udhëhoqi Real Madridin në fitimin e La Ligas, Çampionit, Superkupës së Evropës, Superkupës Spanjolle dhe Botërorin për Klube. Ndërkohë, Real Madridi, i drejtuar prej tij, u bë

**Unë i them vetes: nëse kam 10 ditë këtu, atëherë do t'i jetoj ato 10 ditë deri në maksimum. Nëse është 6 muaj, unë do t'i jetoj ato 6 muaj deri në maksimum. Nuk mendoj përtej kësaj. E di që nuk do të qëndroj trajner i Real Madridit për 10 vjet**

ekipi i parë që e mbron titullin në epokën e Ligës së Kampionëve. Zidan është emëruar edhe "Trajneri më i mirë i FIFA-s", në vitin 2017.



## Pagon një mln euro për të shmangur dënimin me burg

Luka Modrić ka pranuar mashtrimin fiskal të atribuar nga Agjencia Tatimore, lidhur me tatimin e të drejtave të imazhit dhe ka paguar një shifër afër një milion euro për të shmangur një dënim të mundshëm, sipas "El Mundo". Modrić ka kryer dy vepra tatimore, që lidhen me Tatimin mbi të Ardhurat Personale (IRPF) në vitet 2013 dhe 2014. Qëllimi i futbollistit kroat të Real Madridit është të pra-

nojë mendimin e Thesarit dhe të mos e diskutojë atë. Edhe pse lojtari nuk përfundon duke rënë dakord me akuzat dhe konsideron se ai nuk ka vepruar në mënyrë të parregullt, ka vendosur të bëjë pagesën e sipërcituar. Ai konsideron se, për shkak të shumës me të cilën përballlet, nuk kompenson marrjen e rreziqeve dhe luftës ligjore me Thesarin, siç po bën bashkëlojtari i tij, Cristiano Ronaldo.

## Në Kinë ka një çështje "Aubameyang"

Aubameyang kthehet në çështje në Kinë. Guangzhou Evergrande, skuadër që drejtohet nga italiani Fabio Cannavaro, është detyruar të përgënjeshtrojë zërat për një marrëveshje me Borussia Dortmundit për transferimin e sulmuesit me origjinë nga Gaboni për 72 milionë euro gjatë verës së ardhshme. Edhe Federata Kineze e Futbollit ka reaguar për këtë çështje, duke nisur një hetim. Në komunikatën e Guangzhou shkruhet se "historia e blerjes së një futbollisti nga Bundesliga për një shifër që është ndjeshëm më e lartë se tavanin i përcaktuar në

rregulloren e federatës është e pavërtetë. Guangzhou Evergrande do të vijojë t'i respektojë me rigorozitet rregullat për transferimet e lojtarëve", thuhet në komunikatën e skuadrës kineze. Ndërsa Federata në qëndrimin e saj shkruan "se dy klubeve që kanë nisur një luftë ekonomike për një lojtar të huaj (Guangzhou dhe Beijing Guoan) u kemi dërguar një letër për të shpjeguar situatën si dhe kemi nisur një hetim për të kuptuar nëse janë thyer rregullat. Në rast se vërtetohen parregullsitë, dënimet do të jenë të ashpra", thonë nga Federata.





**DASHI** 21. mars - 20. prill

Bëhuni gati për të jetuar një ditë plot energji pozitive, veçanërisht nëse jeni në çift. Kjo e martë do ju favorizojë të shpenzoni sa më shumë kohë me të dashurin/en tuaj dhe të jeni të lumtur. Beqarët mund të kalojnë momente gëzimi me njerëzit më të rëndësishëm. Mbrëmje argëtuese familjare. Në punë, ambicia dhe dëshira për të realizuar projektet tuaja do mbështeten edhe nga yjet.



**DEMI** 21. prill - 21. maj

Ju ndjeheni të pakënaqur me marrëdhënien tuaj në çift. Për shkak të kokëfortësisë suaj mund të ketë keqkuptime me të dashurin/en tuaj, por që mund t'i gjeni një zgjidhje. Zemrat e vetmuara do të jetojnë momente emocionuese falë njohjeve të reja. Mos bëni përpjekje për të marrë përsipër punë më të vështira se kapaciteti juaj në fushën ekonomike.



**BINJAKET** 22. maj - 21. qershor

Nëse jeni duke përjetuar një marrëdhënie të re apo të vjetër sentimentale nuk do të ketë surpriza të veçanta, por yjet premtajn momente magjike. Marrëdhëniet janë të kënaqshme! Ata që janë vetëm duhet të përpiqen të shmangin ndërlikimet e pavevojshme nëse duan të jenë të qetë.



**GAFORRJA** 22. qershor - 22. korrik

Për të shmangur konfliktet me personin e zemrës, do të ishte më mirë të vendosni gjërat në një tekst të qartë. Mundohuni që gjithçka ta diskutoni me qetësi me partnerin/en dhe përballë njeri-tjetrit, jo në distancë. Beqarët do të jenë të shoqërueshëm, por edhe me plot kontradikta. Një vendim i qartë në punën tuaj i jep fund një periudhe pasigurie.



**LUANI** 23. korrik - 22. gusht

Sot do shfaqni anën tuaj më të mirë romantike. Nëse doni që marrëdhënia juaj me partnerin/en të jetë përgjithmonë, kjo është koha për ta bërë këtë. Për beqarët do të ketë takime të reja dhe shumë të këndshme. Ju do të jeni mjaft të dashur dhe të edukuar me personat e rinj.



**VIRGJERESHA** 23. gusht - 23. shtator

Për fat të keq, nganjëherë gjërat e bukura nuk zgjasin shumë, por nuk mund të bëni asgjë për këtë. Nëse duhet të mbyllni një histori, bëjeni tani dhe largojeni të kaluarën. Beqarët do të kenë kohë për të analizuar situatën e tyre për të vendosur se çfarë duhet të bëjnë. Mundohuni të shmangni shpenzimet e tepërta dhe të mos tundoheni nga investimet që duken shumë tërheqëse.



**PESHORJA** 24. shtator - 23. tetor

Merrni përparësi të plotë gjatë kësaj faze të favorshme në jetën tuaj private. Pasioni është i lartë dhe marrëveshja me partnerin/en është në momentin më të mirë se kurrë. Beqarët do të jenë plot me mendime pozitive dhe do të përpiqen të jetojnë çdo moment të kësaj dite me gëzim. Në punë mos u mbështetni gjithmonë te fati, sepse mund të keni shumë zhgënjime.



**AKREPI** 24. tetor - 22. nëntor

Ndonjëherë e sheh veten si një peshk jashtë ujit dhe këtë ndjenjë shqetësimi mendoni se e transmetoni tek ata që janë përreth jush. Jini më pak të shqetësuar dhe më të qëndrueshëm. Beqarët mund të jetojnë lidhje të komplikua, prandaj bëjnë mirë t'i kushtojnë vëmendjen e duhur njohjeve. Financat do shënojnë një rimëkëmbje, kështu që ju mund të argëtoheni duke bërë blerje.



**SHIGJETARI** 23. nëntor - 21. dhjetor

Partneri/ja ju jep gjithë sigurinë dhe stabilitetin që ju nevojitet dhe kjo ju ka larguar nga surprizat. Kompensojeni duke menduar një gjest të bukur! Beqarët do të duhet të frenojnë impulsivitetin e tyre në mënyrë që të mos bëjnë një përshtypje të keqe në takime. Nismat e guximshme dhe vendet e reja të punës favorizohen sot. Besoni në aftësitë tuaja dhe ju do të shpërbleheni.



**BRICJAPI** 22. dhjetor - 20. janar

Ju nuk mund të planifikoni të ardhmen nëse nuk zgjidhni më parë të kaluarën. Jepini përparësi marrëdhënies nëse doni të jetoni më mirë jetën tuaj në çift. Për beqarët do të jetë një e martë e mbushur me surpriza, por edhe me kontraste me disa anëtarë të familjes. Mundësitë dhe ofertat interesante të punës po shumëfishohen. Duke pasur parasysh fitimet e reja, ju mund të guxonit!




**UJORI** 21. janar - 19. shkurt

Gëzojuni kësaj dite të qetë ju që jeni në një lidhje dhe përpiquni të relaksoheni për të rikuperuar gjendjen tuaj. Mundohuni të ndryshoni pamjen tuaj ose të organizoni një darkë jashtë për të fituar më shumë vëmendjen dhe dashurinë e partnerin/es. Pas një periudhe stresi, beqarët do të zbulojnë se mund të jetë më mirë që të kalojnë pak më shumë kohë vetëm.



**PESHQIT** 20. shkurt - 20. mars

Vlerësoni këtë moment romantik dhe pasionant. Së bashku me partnerin/en do jetoni sot në një botë të mbushur me lumturi. Edhe ata që janë vetëm do të duhet të ndryshojnë pretendimet e tyre nëse duan të gjejnë shpirtin e tyre binjak. Aftësitë tuaja janë të pamohueshme, por kur përballen me një problem të madh, ato duken të padobishme.



KOHA	ENËT. SAHANAT	QË KA TË BËJË ME KULTURËN E LASHTË MEKSIKANE	KALIUMI	KOHA	SIPËRFAQE E MADHE UJORE (SH.) ALEKSANDRI	EMËR I DISA PARCEVE TË NJOHUR NË BOTE
NË SASI TË VOGËL				QYTET NË KANADA SUECIA		
JAKOB ZUMA			MËSUESJA JONË, QIRIAZI KRYEQYTETI I MAqedonisë			
AGJENCIA TELEGRAFIKE SHQIPTARE				JO KONVEKS GURU INDIAN, BABA		
VENDLINDJA E BOKSIERIT NË FOTO					THIRRJE TELEFONIKE NJËSIA E REZISTENCËS ELEKTRIKE	
UJË (ITAL)				HËNË E JUPITERIT KELVINI		ELEKTRICITET OKSIGJENI
QILIM					SASI SHUMË E MADHE, SHUMICË	

ZGJIDHJET: L, XHAUL, ORTA, ORTEK, XHIRO, FO, S, POLET, RAME, DETE, PAK, LAMONT, JZ, SEVASTI, ATSH, KONKAV, TEKSAS, ALO, AKUA, IO, EL, TEPK, MORI.

## Sudoku

shumë i lehtë

mesatar

				6				4	4	5			2			3	1	
		1	3		2			5	7		2	1				8	4	
			1		9					3								2
	4	6	9				2	7					9	3	8			
5									9				1		4			8
	2	9			5	4	6						7	5	2			
				2		3				2								5
	8		6		7	5					6	5				4	7	
3	6			1						9	8			4			2	6

Shumë i lehtë: 732568914, 691342857, 458179326, 846931275, 573426189, 129785463, 917253648, 284697531, 365814792. Mesatar: 457826931, 621395847, 398471562, 716938254, 532164798, 849752613, 274619385, 165283479, 983547126.

## Binjaket i mbijetojnë operacionit të ndarjes



Dy binjake nga Gaza, të cilat kishin lindur të ngjitura me njëra tjetrën, i kanë mbijetuar operacionit për t'i ndarë trupat e tyre. Farah dhe Haneni, iu nënshtruan një operacioni në një spital për fëmijë në Rijad të Arabisë Saudite, shkruan BBC. Vajzat kishin të ndara mushkëritë dhe zemrat por se ndanin vetëm një këmbë. Operacioni i tyre ka përfunduar me shumë sukses, ndërsa binjaket tani janë pranë familjarëve.



## Një program për të kufizuar përdorimin e telefonave nga fëmijët?

Apple i është kërkuar ndërtime dhe hedhjen në treg të një programi, apo formë tjetër zgjidhjeje që do të kufizojë përdorimin e telefonave të saj nga ana e fëmijëve. Thirrje të tilla janë të shpeshta, por e veçanta e kësaj të fundit është se bëhet nga dy grupe investitorësh që zotërojnë 2 miliardë dollarë aksione të gjigantit amerikan të teknologjisë. Apele për më shumë kontroll sesi të rinjtë, veçanërisht fëmijët dhe adoleshentët shpenzojnë kohën e tyre me telefonat dhe pajisjet e tjera inteligjente është mirëpritur nga akademikët, institutet, kolegjet dhe universitetet në Kaliforni dhe mbarë SHBA-në. Sipas Reuters, në një studim të fundit është vërejtur se gjysma e adoleshentëve amerikanë besojnë se kanë krijuar varësi nga telefonat e tyre dhe "nevoja për t'iu përgjigjur menjëherë mesazheve në ta".

## Parlamenti britanik, "fans" i faqeve pornografike



Më shumë se 24.000 përpjekje janë bërë për të hyrë në faqe interneti pornografike nga ndërtesa e parlamentit britanik në pesë muajt që pasuan zgjedhjet e përgjithshme të qershorit të shkuar. Sipas shifrave zyrtare, 24.473 tentativat, apo 160 në ditë, u bënë nga kompjuterët apo pajisjet e tjera elektronike të lidhur me rrjetin e parlamentit që përdoret nga deputetët, stafi i tyre si dhe nëpunësit nga qershori në tetor. Ky zbulim vjen ndërsa vijon skandali ish zëvendëskryeministrit Damian Greenm, i cili dha dorëheqjen pasi gënjeu për materiale pornografike që u gjetën në kompjuterët e zyrës së tij në vitin 2008. Të dhënat për pre-

ferencat e fundit audiovizive të stafit të parlamentit britanik i morën pas një kërkesë të shoqatës së shtypit bazuar në ligjin për lirinë e informacionit. Shtatori i shkuar ishte më i ngarkuari me mbi 9000 përpjekje për të hyrë në faqet pornografike nga kompjuterët e parlamentit në dhomën e lordëve dhe dhomën e ulët. Zyrtarë të parlamentit thanë se faqet pornografike janë të bllokuara në rrjetin e tyre, prandaj shumica e përpjekjeve për ti hapur nuk janë me dashje. megjithatë, një tjetër statistikë thotë se vitin e shkuar pati thuhetse 3 milionë përpjekje për të hapur faqe të bllokuara nga rrjeti i parlamentit.



## Sauditet mund të shohin ndeshje futbollit

Gratë në Arabinë Saudite do të lejohen, këtë muaj, të marrin pjesë për herë të parë në ndeshjet e futbollit në mbretërinë konservatore, njoftuan sot autoritetet. "Tifozet do të hyjnë në stadiumet e mëdha sportive të mbretërisë për të marrë pjesë në tre ndeshje futbollit në Ligën Profesionale Saudite", sipas një deklaratë të Qendrës për Komunikim Ndërkombëtar e drejtuar

nga qeveria. "Tre ndeshjet e para janë planifikuar të zhvillohen të premtën, të shtunën dhe më 18 janar", sipas deklaratës. Në tetor, Autoriteti i Përgjithshëm i Sporteve Saudite, një agjenci shtetërore njoftoi në fillim të vitit 2018 se tre stadiumet e frekuentuara deri më tani nga burrat do të planifikohen edhe për familjarët me vende të posaçme.

49 BC - Jul Cezari kalon Rubikonin duke sinjalizuar fillimin e luftës civile.

1475 - Stefani III i Moldavisë mund Perandorinë Osmane në Betejën e Vasluit.

1806 - Holandezët në Kejptaun i dorëzohen britanikëve.

1810 - Kisha franceze anulon martesën e Napoleonit I me Zhozefinën

1839 - Çaji i Indisë për herë të parë arrihet në Britani të Madhe.

1861 - Florida bëhet shteti i tretë që ndahet nga SHBA.

1863 - Hapet hekurudha e parë nëntokësore në Londër.

1889 - Bregu i Fildishtë shpallet protektorat i Francës.

1901 - Nafta zbulohet në Teksas.

1916 - Rusia sulmon Kaukazin.

1920 - Themelohet Lidhja e Kombeve.

1928 - Bashkimi Sovjetik urdhëron dëbimin e Trockit.

1964 - Panama ashpëson marrëdhëniet diplomatike me SHBA.

1966 - India & Pakistan nënshkruajnë Traktat të Paqes.

## Izraeli kultivon domatet sa një boronice



Kompania "Kedma" në Izrael, është duke kultivuar domaten më të vogël në botë, e ajo ka madhësinë e një boronice. Kjo kompani njihet për inovacionin e saj bujqësor, ku frutat dhe perimet janë marrë seriozisht dhe fillojnë të shpiknin gjëra interesante rreth tyre. Siç shkruajnë mediat e huaja, ideja e tyre është që të rrisin bimë të ndryshme në miniaturë. Domatet në Izrael janë shumë të popullarizuara, e madhësia e një boronice tani ofrohet me ngjyrë të kuqe dhe të verdhë.

## POLICI DHE BIONDJA

Një polic duke e ruajtur një dyqan mallrash. Në mbrëmje kishte filluar të bjerë shi.

Del një biondinë në ballkon dhe i thotë: - Eja e hyrë brenda se po bjerë shi.

Polici ia kthen: - Jo faleminderit se edhe jashtë është duke rënë shi.



Të gjithë ata që merren me politikë, duhet ta kenë qartë që nuk duhet të varen vetëm nga një grup i interesit. Një vendim i mirë është ai në të cilin të gjithë japin kontribut.

(Angela Merkel)



KALENDARI HISTORIK 10 JANAR



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS